



# RAPORTI I MONITORIMIT TË GJYKIMEVE MBI MASËN E PARABURGIMIT

Tetor 2023



**RAPORTI I**  
**MONITORIMIT TË**  
GJYKIMEVE MBI MASËN E  
PARABURGIMIT

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	5
<b>1. HYRJE</b> .....	7
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	10
<b>3. KORNIZA LIGJORE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE</b> .....	11
3.1 Standardet ndërkombëtare .....	11
3.1.1 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.....	11
3.1.2 KEDNJ dhe jurisprudenca e GJEDNJ .....	12
3.2 Korniza ligjore e Kosovës .....	13
3.2.1 Kodi i Procedurës Penale.....	13
<b>4. MONITORIMI I GJYKIMEVE: ANALIZË STATISTIKORE DHE SHEMBUJ TË RASTEVE</b> 18	
4.1 Planifikimi i rasteve dhe gjetjet paraprake .....	18
4.2 Shembuj të rasteve.....	21
4.2.1 Dështimi i prokurorëve për të siguruar prova të dyshimit të bazuar.....	21
4.2.2. Dështimi i prokurorëve për të arsyetuar ose individualizuar kërkesat për paraburgim .....	22
4.2.3 Dështimi i prokurorëve për të saktësuar se përse masat alternative nuk mund të sigurojnë praninë e të pandehurit në gjykim .....	25
4.2.4 Dështimi i avokatëve mbrojtës për t'i atakuar në mënyrë adekuate kërkesat për paraburgim ose për të propozuar masa më pak kufizuese .....	25
4.2.5 Dështimi i gjyqtarëve për të arsyetuar ose individualizuar mjaftueshëm vendimet për paraburgim .....	28
4.2.6 Mospërbushja e afateve procedurale nga Gjykata e Apelit .....	31
<b>5. KONKLuzion</b> .....	34
<b>6. REKOMANDIME</b> .....	36
<b>SHTOJCA A</b> .....	38
<b>SHTOJCA B</b> .....	40

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>KKGJE</b>	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë
<b>KPK</b>	Kodi penal i Kosovës
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KPPK</b>	Kodi i procedurës penale i Kosovës
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>PNDCP</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
<b>AKK</b>	Akademia e Drejtësisë e Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>OAK</b>	Oda e Avokatëve të Kosovës
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë
<b>ODIHR</b>	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ofron një analizë të të dhënave të mbledhura gjatë viteve 2022 dhe 2023 mbi përdorimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve të moshës madhore në Kosovë<sup>1</sup> në suazat e programit për monitorim të gjykimeve të Misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Qëllim i këtij raporti është analizimi i shqiptimit të masës së paraburgimit nga shtatë gjykatat themelore të Kosovës<sup>2</sup> nga prizmi i pajtueshmërisë me standardet e pranuar ndërkombëtarisht për gjykim të drejtë, bazuar në monitorimin e gjykimeve nga ana e OSBE-së. Ai synon të shërbejë si mjet didaktik për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, dhe ofron rekomandime përkitazi me trajnimet për Akademinë e Drejtësisë të Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës.

Përdorimi i tepërt i masës së paraburgimit përbën një problematikë mbarëbotërore që ngre shqetësime për sa i përket sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Kosova nuk përbën përjashtim në këtë aspekt. Statistikat e disponueshme tregojnë se, që nga dhjetori i vitit 2020, është rritur ndjeshëm numri i të akuzuarve që mbahen në paraburgim e që janë akoma në pritje të dënimit.

Raporti bazohet në të gjeturat nga monitorimi dhe analizimi i 70 seancave dëgjimore për caktim të paraburgimit të monitoruara dhe analizuara nga OSBE-ja. OSBE-ja filloi me analizën në fjalë pjesërisht për shkak të raporteve anekdotike mbi trajtimin jouniform të kërkesave për caktimin e paraburgimit nga gjykatat themelore, ku disa gjykata urdhëronin paraburgimin më shpesh se sa të tjerat. Analiza e OSBE-së ka përfituar ng pesë qendrat rajonale të Misionit të OSBE-së,<sup>3</sup> që të gjitha të pajisura me monitorues të gjykimeve të cilët i monitorojnë rregullisht rastet në të shtatë gjykatat themelore dhe, si e tillë, ishte në pozitë unike që të analizojë zbatimin e masës së paraburgimit nëpër gjykatat e Kosovës.

Një nga gjetjet kryesore të analizës është se nuk ka pasur ndonjë dallim të dukshëm ndërmjet gjykatave sa i përket trajtimit të kërkesave për paraburgim.<sup>4</sup> Analiza ka shpalosur se gjyqtarët e procedurës paraprake i kanë refuzuar rrallëherë kërkesat e prokurorisë për paraburgim dhe se “masat më të buta” janë përdorur shumë pak si alternativë e disponueshme.

1 Objekt shqyrtimi i këtij raporti është vetëm masa e paraburgimit për të pandehur të moshës madhore. Për masën e paraburgimit ndaj “të pandehurve të mitur” duhet të merren në konsideratë çështje tjera që nuk janë objekt shqyrtimi i këtij raporti. Shih nenin 61, Kodi nr. 06/L-006, Kodi i drejtësisë për të mitur, 18 tetor 2018;

2 Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Gjakovë, Gjykata Themelore në Pejë, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Gjykata Themelore në Gjiilan, dhe Gjykata Themelore në Ferizaj.

3 Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

4 Relevanca e kësaj gjetje duhet vlerësuar në raport me madhësinë relativisht të vogël të mostrës.

Nga 70 kërkesat e analizuara, vetëm gjashtë sosh janë refuzuar, gjetje kjo që sugjeron pamjaftueshmëri të mbikëqyrjes dhe ekzaminimit dhe që mund ta dëmtojë parimin e përdorimit të masës së paraburgimit si masë e fundit.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara shpalosin gjithashtu se janë shënuar përmirësime në krahasim me gjetjet në raportet paraprake të OSBE-së.<sup>5</sup> Në veçanti, afatet procedurale për paraqitjen e kërkesave për caktim të paraburgimit dhe nxjerrjen e aktvendimeve përkatëse, dhe obligimit për “mbrojtje të detyrueshme” (d.m.th. përfaqësimit të të gjithë të pandehurve). Aty ku është e përshtatshme, raporti thekson shembuj të praktikave të mira në çështjet e paraburgimit.

Nga ana tjetër, raporti vë në dukje mangësi në lidhje me cilësinë e arsytimit në kërkesat e prokurorisë, parashtresat e mbrojtjes dhe vendimet gjyqësore. Shqetësime të veçanta janë identifikuar në rastet me të pandehur të shumtë, ku prokuroria dhe gjykatat shpesh nuk kanë arritur t’i diferencojnë mjaftueshëm rrethanat dhe përfshirjen e pretenduar të secilit të pandehur.

Raporti përmbillet me disa rekomandime drejtuar institucioneve përkatëse. Rekomandimet kryesore janë: zgjerimi i listës së masave të disponueshme që mund të përdoren si alternativë ndaj paraburgimit; sigurimi i ekzistimit të mekanizmave për monitorim dhe përsheptim të procedurës në rastet kur i pandehuri ndodhet në paraburgim; mbledhja dhe publikimi i të dhënave për përdorimin e masës së paraburgimit; ofrimi i trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë për çështje që lidhen me paraburgimin.

---

<sup>5</sup> Shih raportin e OSBE-së “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura” – Pjesa I (nëntor 2009). <https://www.osce.org/files/f/documents/5/5/40584.pdf> (qasur më 18 korrik 2023); dhe raportin e OSBE-së “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura” – Pjesa II (mars 2010). <https://www.osce.org/files/f/documents/b/e/41806.pdf> (qasur më 18 korrik 2023). Shih po ashtu raportin e OSBE-së “Shqyrtim i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë”, qershor 2016. <https://www.osce.org/kosovo/243976> (qasur më 18 korrik 2023).

# 1. HYRJE

“E drejta për liri personale nuk është absolute. [Neni 9] pranon se privimi i lirisë ngandonjëherë justifikohet si, për shembull, në suazat e zbatimit të ligjeve penale. [Ai] kërkon që privimi i lirisë të mos jetë arbitrar dhe të bëhet duke e respektuar sundimin e ligjit. [...] nuk duhet të jetë praktikë e përgjithshme që të pandehurit t'i nënshtrohen paraburgimit.”

- Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Komenti i përgjithshëm nr. 35: neni 9 (Liria dhe siguria personale)*<sup>6</sup>

Misioni i OSBE-së në Kosovë ("OSBE") e monitoron sistemin e drejtësisë së Kosovës në raport me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë dhe të të drejtave të njeriut që nga viti 1999. Bazuar në këtë monitorim, OSBE-ja nxjerr rregullisht raporte me qëllim të përmirësimit të funksionimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë, dhe pajtueshmërinë me standardet e pranuar ndërkombëtarisht të gjykimit të drejtë, me fokus në identifikimin e problematikave sistimore në vend se të atyre të izoluar, dhe jep rekomandime për përmirësimin e sektorit të drejtësisë.

Përdorimi i masës së paraburgimit është temë me rëndësi të madhe për OSBE-në, sepse i prek drejtpërsëdrejti dhe thellësisht të drejtat themelore të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për liri, e cila është përshkruar si e "rëndësisë më të madhe në një 'shoqëri demokratike'".<sup>7</sup> Organet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut kanë nënvizuar se paraburgimi duhet "të jetë përjashtim dhe jo rregull",<sup>8</sup> që përdoret vetëm kur është absolutisht i domosdoshëm dhe vetëm si masë e fundit.<sup>9</sup>

Popullsia e burgjeve paraqet një tregues të dobishëm të shkallës së përdorimit të masës së paraburgimit. Statistikat e Shërbimit Korrektues të Kosovës tregojnë se ka pasur rritje të konsiderueshme të përqindjes së popullsisë së burgjeve që gjenden në paraburgim tre vjetët e fundit, shifër kjo që e arriti kulmin në dhjetor 2022, kur numri i të burgosurve në pritje të gjykimit ishte 660 nga gjithsej 1726 persona të ndaluar (38 për qind e popullsisë së burgjeve).

6 Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Komenti i përgjithshëm nr. 35 për nenin 9 (Liria dhe siguria personale)*, CCPR/C/GC/35, 16 dhjetor 2014, paragrafët 10 dhe 38, gjendet tek: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G14/244/51/PDF/G1424451.pdf?OpenElement> (qasur më 18 korrik 2023).

7 Medvedyev dhe të tjerët kundër Francës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, aktgjykimi i datës 29 mars 2010, paragrafi 76.

8 Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Komenti i përgjithshëm nr. 35 për nenin 9 (Liria dhe siguria personale)*, paragrafi 38.

9 Këshilli i Evropës, *Rekomandimi Rec (2006)13 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për përdorimin e masës së paraburgimit, kushtet në të cilat realizohet dhe vendosjes së masave mbrojtëse kundër abuzimit me të*, paragrafi 3. <https://pjp-eu.coe.int/documents/41781569/42171329/CMRec+%282006%29+13+on+the+use+of+remand+in+custody%2C+the+conditions+in+which+it+takes+place+and+the+provision+of+safeguard+against+abuse.pdf/ccde55db-7aa4-4e11-90ba-38e4467efd7b> (qasur më 18 korrik 2023).



## Popullsia e burgjeve në Kosovë 2020 - 2023




Figura 1. Popullata e burgjeve në Kosovë 2020-2023

Kosova nuk është e vetmja me një trend të këtillë. Përdorimi i tepërt i masës së paraburgimit është vënë në dukje nga organizatat në Evropë dhe mbarë globin.<sup>10</sup> Të dhënat e botuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian shpalosin se, në vitin 2021, përqindja mesatare e popullsisë së “padënuar” të burgjeve (d.m.th. që nuk janë duke vuajtur dënimin e shqiptuar) në shtete anëtare të Bashkimit Evropian ishte 24.6 për qind.<sup>11</sup>

OSBE ka raportuar lidhur me përdorimin e masës së paraburgimit në Kosovë edhe më herët. Në vitet 2009 dhe 2010, OSBE ka nxjerrë dy raporte me konkluzën se korniza ligjore në fuqi nuk ishte zbatuar plotësisht dhe se masa e paraburgimit nuk përdorej në përputhje me standardet ndërkombëtare.<sup>12</sup>

10 Shih po ashtu Komentin e Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut: *Përdorimi i tepërt i masës së paraburgimit cenon të drejtat e njeriut* (18/08/2011), <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/excessive-use-of-pre-trial-detention-runs-against-human-righ-1> (qasur më 18 korrik 2023); Nisma për drejtësi e Fondacionit për Shoqëri të Hapur, “Prezumimi i fajësisë: Përdorimi i tepërt i paraburgimit në nivel botëror” (2014), <https://www.justiceinitiative.org/publications/presumption-guilt-global-overuse-pretrial-detention> (qasur më 18 korrik 2023).

11 Shih shënimin mbi “Dokument jozyrtar nga shërbimet e Komisionit në kontekst të miratimit të Rekomandimit për të drejtat procedurale të dyshuarve dhe të akuzuarve në paraburgim dhe për kushtet materiale të paraburgimit” (Këshilli i Bashkimit Evropian, dhjetor 2022) në dispozicion tek <https://commission.europa.eu/system/files/2022-12/JHA%20Non-paper%20st15292%20en22.pdf> (qasur më 18 korrik 2023).

12 Shih raportin e OSBE “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura – Pjesa I (Nëntor 2009)”, <https://www.osce.org/files/f/documents/5/5/40584.pdf> (qasur më 18 korrik 2023); dhe raportin e OSBE “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura – Pjesa II”, (Mars 2010), <https://www.osce.org/files/f/documents/b/e/41806.pdf> (qasur më 18 korrik 2023).

Ndër brengat e identifikuara në këto raporte ishin mosrespektimi i afateve procedurale, arsyetimet e pamjaftueshme në kërkesat e prokurorisë, performanca e dobët e avokatëve mbrojtës dhe arsyetimet e pamjaftueshme për caktim të masës së paraburgimit në vendimet gjyqësore. Raportet e botuara në vitet 2016 dhe 2022, ndonëse me fokus në tematika tjera, kanë vënë po ashtu në dukje shqetësime të vazhdueshme në lidhje me përdorimin e masës së paraburgimit.<sup>13</sup>

Ky raport ka si qëllim paraqitjen e një analize të përditësuar të shkallës së përdorimit të masës së paraburgimit në Kosovë.<sup>14</sup> Ai synon të shërbejë si ndihmesë për të gjitha institucionet dhe profesionistët përkatës në kuptim të përqafimit të praktikave të mira gjatë zbatimit të legjislacionit ekzistues në pajtim me standardet ndërkombëtare.

---

13 Shih faqe 30, "Shqyrtim i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale" (qershor 2016) në dispozicion tek <https://www.osce.org/files/f/documents/0/8/243976.pdf> (qasur më 18 korrik 2023) dhe faqet 31 dhe 33, "Trajtimi i rasteve të terrorizmit nga sistemi i drejtësisë penale i Kosovës" (shtator 2022) në dispozicion tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/526212> (qasur më 18 korrik 2023).

14 Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata Themelore në Gjakovë, Gjykata Themelore në Pejë, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Gjykata Themelore në Gjilan, dhe Gjykata Themelore në Ferizaj.

## 2. METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në sa vijon:

- i. Hulumtim i literaturës mbi standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e Kosovës;
- ii. Analizën cilësore dhe sasiore e të dhënave të mbledhura gjatë monitorimit të drejtpërdrejtë nga OSBE të seancave dëgjimore për caktim të paraburgimit në periudhën janar-dhjetor 2022, dhe të seancave në apel në vitin 2023;
- iii. Analizën cilësore të kërkesave të prokurorisë, parashtresave të mbrojtjes dhe vendimeve gjyqësore lidhur me paraburgimin;
- iv. Monitorimin e seancave dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së këtyre seancave nga ana e monitoruesve të OSBE-së.

Për qëllime të këtij raporti, gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, OSBE ka përzgjedhur dhe monitoruar 70 raste, ku kanë qenë të përfshirë 96 të pandehur, para gjashtë gjykatave themelore të Kosovës. Në shumicën e rasteve, OSBE i ka monitoruar rastet drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet analizimit të kërkesave dhe aktvendimeve gjyqësore. Dymbëdhjetë (12) raste (17 për qind), janë analizuar nëpërmjet shqyrtimit të dosjeve të lëndëve dhe dokumentacionit përkatës, por nuk janë monitoruar drejtpërsëdrejti, gjegjësisht me prani fizike të monitoruesve në gjykatore.

I vetmi kriter për përzgjedhjen e rasteve ishte vendndodhja e gjykatës themelore, me qëllim monitorimin e afërsisht dhjetë seancave për caktim të paraburgimit për secilën gjykatë themelore. Si rrjedhim, raporti ofron hollësi rreth seancave dëgjimore për një spektër të gjerë të veprave penale të pretenduara.<sup>15</sup>

Metodologjia e monitorimit të gjyqimeve të cilën e kanë përdorur monitoruesit e OSBE-së bazohet në metodën dhe parimet e e ODIHR-it për monitorimin e gjyqimeve që përshkruhet në doracakun për profesionistët e fushës të botuar nga ODIHR në vitin 2012.<sup>16</sup> Më tej, për të siguruar konsistencë të mbledhjes dhe analizës së të dhënave për secilin rast, është përpiluar një formular për monitorim të gjyqimeve që është përdorur nga monitoruesit e OSBE gjatë monitorimit të seancave.

Analiza e rasteve është bazuar në vlerësimin e zhvillimit të seancave dëgjimore dhe shqyrtimin e dokumenteve përkatëse përfshirë këtu kërkesat e prokurorisë, parashtresat e mbrojtjes dhe aktvendimet gjyqësore.

Për qëllime të këtij raporti, OSBE ka monitoruar dhe analizuar vetëm kërkesat e para për caktim të paraburgimit, e që kanë qenë zakonisht seanca të mbyllura për publikun në fazën e hetimeve. Aktvendimet e mëpastajme për zgjatje të paraburgimit, ose kohëzgjatja e gjithmbarshme e mbajtjes në paraburgim në rastet në fjalë nuk kanë qenë pjesë e analizës. Veç kësaj, OSBE ka siguruar dhe analizuar dokumentet nga gjashtë seanca apeli që janë realizuar në periudhën shkurt-maj 2023. Gjetjet kryesore të analizës janë paraqitur në hollësi në një pjesë të shkurtë në fund të raportit.

<sup>15</sup> Për më shumë, shih Kapitullin 4.1 "Përcaktimi i rasteve dhe gjetjet fillestare".

<sup>16</sup> Zyra e OSBE për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), *Doracak për monitorim të gjyqimeve: Doracak për referencë për profesionistët (botim i rishikuar, 2012)*, <https://www.osce.org/odihr/94216> (qasur më 18 korrik 2023).

## 3. KORNIZA LIGJORE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

### 3.1 Standardet ndërkombëtare

Paraburgimi paraqet kufizimin më të rëndë të së drejtës për liri dhe siguri, dhe përcillet me pasoja të pashmangshme edhe për të drejtat e tjera si e drejta për jetë private dhe familjare.

Si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) ashtu edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) janë të mishëruara në legjislacionin e Kosovës përmes Kushtetutës.<sup>17</sup> Kushtetuta parasheh që gjykatat t'i interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).<sup>18</sup> Këto instrumente, bashkë me vendimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe ato të GJEDNJ-së përbëjnë një artikullim gjithëpërfshirës të standardeve të të drejtave të njeriut që zbatohen për paraburgimin.

Ndërsa njohin se paraburgimi mund të jetë i justifikuar në rrethana të caktuara, instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut parashohin kufizime strikte për zbatimin e tij. Këto kufizime synojnë shmangien e zbatimit arbitrar ose të tepruar të paraburgimit. Shumë standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë pasqyruar edhe në Rekomandimin e nxjerrë së fundmi nga Komisioni Evropian *“si për të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të akuzuarve që gjenden në paraburgim ashtu edhe për kushtet materiale të paraburgimit”*.<sup>19</sup>

#### 3.1.1 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

PNDCP përcakton se askush nuk duhet të jetë objekt i arrestimit ose burgimit arbitrar dhe se çdo privim i lirisë duhet të jetë në përputhje me procedurën e *“paraparë me ligj”*.<sup>20</sup> Gjithashtu, PNDCP parasheh që *“[ç]do person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një vepre penale duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatës”* dhe duhet të ketë të drejtë ankese lidhur me ligjshmërinë e masës së paraburgimit.<sup>21</sup> Më tej, pakti përcakton se *“[m]bajtja në paraburgim e personave të cilët presin të gjykohen nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm”*.<sup>22</sup> Për më tepër, paraburgimi në pritje të gjykimit *“duhet të jetë i arsyeshëm dhe i domosdoshëm në të gjitha rrethanat”*.<sup>23</sup>

Komisioni për të Drejtat e Njeriut ka sqaruar përmes udhëzimit se çfarë përbën arbitraritet, duke gjykuar se edhe kur përcaktohet përmes legjislacionit vendor, paraburgimi mund të jetë arbitrar megjithatë. Në këtë kontekst, *“arbitrariteti”* përfshinë *“elemente të mos përshtatshmërisë, padrejtësisë, mungesës së parashikueshmërisë dhe procesit të duhur ligjor, si dhe element të arsyeshmërisë, nevojës dhe proporcionalitetit”*.

17 Neni 22, Kushtetuta e Kosovës, 9 prill 2008. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është po ashtu e detyrueshme në Kosovë sipas nenit 53 të Kushtetutës;

18 Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës;

19 Rekomandim i Komisionit (BE) 2023/681 i 8 dhjetorit 2022 mbi të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të akuzuarve në paraburgim dhe kushtet materiale të paraburgimit, në dispozicion tek <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32023H0681> (qasur më 18 korrik 2023).

20 Neni 9(1) i PNDCP.

21 Neni 9(3) dhe (4) i PNDCP. Për sa i përket domethënies së *“pa vonesë”*, Komisioni ka deklaruar afati kohor prej 48 orësh nga momenti i arrestit deri në seancën gjyqësore është i pranueshëm. Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Koment i përgjithshëm nr. 35 lidhur me nenin 9*, paragrafi 33.

22 Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Koment i përgjithshëm nr. 35 lidhur me nenin 9*, paragrafi 38.

23 Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Koment i përgjithshëm nr. 35 lidhur me nenin 9*, paragrafi 12.

Gjithashtu, i rëndësishëm në kontekstin e Kosovës është konstatimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut se,

*“paraburgimi në pritje të gjykimit duhet të bazohet në një përcaktim të individualizuar se është i arsyeshëm dhe i nevojshëm, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, për qëllime të pengimit të ikjes, ndërhyrjes në prova ose përsëritjes së veprës penale.”*

Për më tepër, ka konstatuar se *“paraburgimi në pritje të gjykimit nuk duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë të pandehurit e akuzuar për një vepër penale të caktuar, pa marrë parasysh rrethanat individuale”* dhe nuk duhet të bazohet vetëm në *“dënimin e mundshëm për veprën penale të ngarkuar”*.<sup>24</sup>

### 3.1.2 KEDNJ dhe jurisprudenca e GJEDNJ

Ngjashëm me PNDKP, GJEDNJ-ja thotë, në nenin 5, askush nuk mund të privohet nga liria, me përjashtim të rasteve të numëruara që përfshijnë:<sup>25</sup>

*“arrestimin ose ndalimin e ligjshëm të personit për ta çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer vepër penale ose kur në mënyrë të arsyeshme çmohet se është e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose ikjen e tij pas kryerjes së saj.”*<sup>26</sup>

Çdo privim nga liria duhet bërë në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj.<sup>27</sup> për më tepër, personi duhet *“...të sillet menjëherë para gjyqararit...”* dhe ka *“...të drejtë për gjykim brenda një kohe të arsyeshme...”*.<sup>28</sup> GJEDNJ-ja thekson më tej se *“...lirimi mund të kushtëzohet me garanci për t'u paraqitur në proces gjyqësor”*.<sup>29</sup>

Ashtu siç është rasti për të gjitha të drejtat e kualifikuara sipas KEDNJ-së, çdo kufizim duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional. Autoritetet duhet të balancojnë rëndësinë e respektimit të së drejtës themelore të njeriut për liri kundrejt domosdoshmërisë për të siguruar pjesëmarrjen në proces. Autoritetet gjyqësore duhet të shqyrtojnë nëse masat më të buta se paraburgimi mund të jenë të mjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurit në gjykim dhe të vendosin për paraburgim vetëm kur është rreptësisht e nevojshme.<sup>30</sup>

24 Komisioni për të Drejta të Njeriut i OKB, Komenti i përgjithshëm nr. 35 në nenin 9, para. 38.

25 Shembuj kur paraburgimi mund të jetë i ligjshëm janë renditur në nenin 5(1)(a-f) të KEDNJ.

26 Neni 5.1(c).

27 Neni 5.1 i KEDNJ.

28 Neni 5.1(c) dhe neni 5.3 i KEDNJ.

29 Neni 5.3 i KEDNJ.

30 *Ladent kundër Polonisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, 18 mars 2008, para. 55.

GJEDNJ ka gjykuar se lehtësia e largimit nga një juridiksion nuk mund të jetë arsyeja e vetme për të arsyetuar rrezikun e ikjes dhe duhet të konfirmohet nga faktorë të tjerë.<sup>31</sup> Rrjedhimisht, gjyqtarët duhet të japin arsyetim të qartë për vendimet e tyre dhe të përvijojnë të gjithë faktorët për të siguruar që vendimet e tyre i përmbushin standardet ndërkombëtare, për të shmangur pretendimet për trajtim diskriminues – veçanërisht ndaj të pandehurve me shtetësi të shumëfishta.

Jurisprudenca e GJEDNJ-së citohet në raport, sa herë që gjen zbatim. Krahas kësaj, Shtojca B e këtij Raporti ofron përmbledhje të disa prej parimeve kryesore që mund të nxirren nga praktika gjyqësore.

### 3.2 Korniza ligjore e Kosovës

Rregullat që e rregullojnë paraburgimin janë të përfshira në Kushtetutë dhe në Kod të Procedurës Penale (“KPP”).<sup>32</sup> Neni 29 i Kushtetutës e parasheh të drejtën e lirisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo dispozitë plotësohet nga neni 30 i Kushtetutës, i cili përcakton të drejtat e të akuzuarit dhe neni 31, i cili e parasheh të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

#### 3.2.1 Kodi i Procedurës Penale

Më 17 shkurt 2023 hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale në Kosovë. Analiza e mëposhtme do t'i referohet KPP-së që është aktualisht në fuqi, me disa fusnota që citojnë gjithashtu dispozitat ekuivalente në KPP-në e mëparshme. Do të theksohen ndryshimet domethënëse që i sjell Kodi i ri i Procedurës Penale. Shtojca A gjithashtu sjellë hollësi nga ndryshimet kryesore në Kodin e ri të Procedurës Penale lidhur me paraburgimin.

Kodi i Procedurës Penale (KPP) rithekson të drejtën e lirisë të paraparë në Kushtetutë.<sup>33</sup> Përveç kësaj, KPP ofron dispozita të hollësishme për procedurën e zbatueshme për përdorimin e paraburgimit.

Kodi i Procedurës Penale thekson se paraburgimi duhet të jetë në përputhje me dispozitat e kodit dhe të shqiptohet për një kohë sa më të shkurtër.<sup>34</sup> Dispozita krijon detyrim për autoritetet që t'i trajtojnë rastet urgjentisht sa herë që një i pandehur mbahet në paraburgim dhe të lirojnë të pandehurit sapo të pushojnë së ekzistuari kushtet që e arsyetojnë paraburgimin.

Gjykata mund ta dërgojë në paraburgim të pandehurin vetëm nëse bindet se ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale. Ky është parakusht për paraburgimin që është i barasvlershëm me testin e “dyshimit të arsyeshëm” të përfshirë në KEDNJ.

Edhe nëse plotësohen kushtet e tjera, nëse gjykata nuk bindet se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer vepër penale, ai duhet të lirohet.

31 Shih *Becciev kundër Moldavisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 4 tetorit 2005, para. 58; *Sulaoja kundër Estonisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 15 shkurtit 2005, para. 64; dhe *Stögmüller kundër Austrisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 10 nëntorit 1969, para. 15.

32 Për më tepër, rregullat që drejtojnë paraburgimin e fëmijëve përmbahen në Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Aspektet e atyre dispozitave nuk janë pikë shqyrtimi e këtij raporti.

33 Neni 12 i Kodit nr. 08/L-032 Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

34 Neni 182, *po aty*.

Nëse gjykata bindet se ekziston dyshimi i bazuar, atëherë ajo vazhdon të shqyrtojë nëse ndonjë nga kushtet e nenit 184 të KPP-së e arsyetojnë paraburgimin. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse “masat më të buta” mund t’i përmbushin këto kushte dhe të urdhërojë paraburgimin vetëm nëse bindet se nuk i përmbushin.<sup>35</sup> Me fjalë të tjera, paraburgimi duhet të jetë si opsion, gjegjësisht masë e fundit.

Masat më të buta përkufizohen në nenin 171(5) si: “premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin;<sup>36</sup> ndalimi për t’iu afruar vendit ose personit të caktuar; paraqitja në stacionin policor; dorëzania ose arresti shtëpiak”. Kjo paraqitet si listë shteruese, e cila në dukje ia pamundëson gjykatës urdhërimin e masave alternative (si p.sh. paraqitja në takime për trajtim të varësisë ndaj drogës/alkoolit, monitorimi elektronik ose kufizimi i lëvizjes).<sup>37</sup>

Lidhur me këtë, vlen të theksohet, Komisioni Evropian ka rekomanduar së fundmi që,

“paraburgimi në pritje të gjyimit duhet të përdoret gjithmonë si masë e fundit bazuar në vlerësimin e bërë në secilin rast veç e veç. Spektri më i gjerë i mundshëm i masave alternative më pak kufizuese ndaj paraburgimit (masat alternative) duhet të vihet në dispozicion dhe të zbatohen kudo që është e mundur. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të sigurojnë që vendimet e paraburgimit të mos jenë diskriminuese dhe të mos shqiptohen automatikisht ndaj të dyshuarve dhe personave të akuzuar bazuar në karakteristikat e caktuara, siç është shtetësia e huaj.”<sup>38</sup>

35 Neni 184, po aty.

36 Neni 174(2), po aty, sqaron se “dokumenti i udhëtimit i të pandehurit të detyruar [të mos largohet nga vendqëndrimi i tij] mund të sekuestrohet”.

37 Dorëzimi i dokumenteve të udhëtimit është një kërkesë e zakonshme që përdoret në shumë juridiksione. Ndërsa kjo në dukje nuk është në dispozicion si një 'masë më e butë' e pavarur, ajo mund të kërkohej kur lidhet me vendqëndrimin ose arrestin shtëpiak. Shih nenin 174(2), “Premtimi i të pandehurit për të mos u larguar nga vendbanimi aktual” dhe neni 181(9), “Arresti shtëpiak”, Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

38 Komisioni Evropian, *Rekomandimi i Komisionit (BE) 2023/681 i datës 8 dhjetor 2022 për të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të akuzuarve që i nënshtrohen paraburgimit para gjyimit dhe për kushtet materiale të paraburgimit*, paragrafi 23 i Preambulës. Gjetendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32023H0681> (e qasur më 18 korrik 2023)




Figura 2. Paraburgimi siç rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

### Procedura e paraqitjes së kërkesave

Prokurori është përgjegjës për paraqitjen e kërkesës fillestare për marrjen e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit duke përfshirë edhe “masat më të buta” dhe paraburgimin<sup>39</sup>. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 36 orëve nga arrestimi i të pandehurit dhe duhet t'i plotësojë kriteret specifike të nenit 163 të KPP-së. Kur kërkon paraburgim, prokurori duhet t'i ndjekë procedurat specifike të përcaktuara në nenin 163(2), duke përfshirë:

- Përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale.
- Përshkrimi i provave që sugjerojnë se:
  - ka rrezik të arratisjes, ose
  - i pandehuri do të pengojë drejtësinë, qoftë duke shkatërruar provat ose duke ndikuar mbi dëshmitarët/palët e dëmtuara, etj., ose
  - pesha e veprës penale, rreziku që ai/ajo do ta përsërisë veprën penale, DHE
  - [të] specifikojë përse janë të pamjaftueshme masat më të buta për të siguruar praninë e të pandehurit.”

<sup>39</sup> Nenet 165(1) dhe (2) dhe 173(4), Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, 28 dhjetor 2012; Nenet 163(1) dhe (2) dhe 171(4), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.



Sipas Kodit të Procedurës Penale të vitit 2012, afati kohor për paraqitjen e kërkesës për paraburgim nga prokuroria ishte 24 orë. KPP i ri (në fuqi nga shkurti 2023) e zgjat afatin kohor në 36 orë. Kjo i jep prokurorisë më shumë kohë për të shqyrtuar domosdoshmërinë e paraburgimit dhe për të hartuar një kërkesë nëse është e nevojshme. Megjithatë, koha brenda së cilës gjykata duhet të shqyrtojë një kërkesë mbetet e pandryshuar në 48 orë. Mbetet për tu parë nëse kjo do të paraqes sfidë për Gjykatat Themelore, të cilave mund të ju mbetet rreth 12 orë kohë për të dëgjuar kërkesën për paraburgim.

Personi i arrestuar ka të drejtën e asistencës së menjëhershme të mbrojtësit të zgjedhur prej tij/saj dhe të përfaqësohet nga avokati mbrojtës në seancën paraprake për paraburgim.<sup>40</sup> Nëse personi nuk angazhon avokat mbrojtës brenda 24 orëve, gjykata duhet t'ia caktojë një mbrojtës sipas detyrës zyrtare.<sup>41</sup>

Në pajtim me standardet ndërkombëtare, KPP parasheh që me pranimin e kërkesës së prokurorisë për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake duhet të mbajë seancën në prani të të pandehurit dhe të avokatit mbrojtës. Seanca duhet të zhvillohet brenda 48 orëve nga momenti i arrestimit.<sup>42</sup> Nëse seanca nuk zhvillohet brenda kësaj kohe, personi duhet të lirohet.<sup>43</sup>

Gjyqtari i procedurës paraprake ka maksimum 48 orë pas seancës për të marrë vendim me të cilin vendos për të caktuar paraburgimin apo ndonjë masë tjetër.<sup>44</sup> Në praktikë, nga monitorimi i OSBE-së është vërejtur se zakonisht vendimet merren menjëherë.

### *Ankesa ndaj aktvendimit për paraburgim*

Palët kanë të drejtë të ankohen kundër aktvendimit për paraburgim. Në mesin e ndryshimeve në KPP-në e re është edhe ndryshimi i afatit për paraqitjen e ankesës, për të lejuar 48 orë nga pranimi i aktvendimit të Gjykatës Themelore.<sup>45</sup> Sipas dispozitave të vjetra, ky afat kohor ishte 24 orë.<sup>46</sup>

Nëse njëra nga palët paraqet ankesë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër, e cila mund të depozitojë pastaj përgjigje brenda 24 orëve nga pranimi i saj.

Pastaj, Gjykata e Apelit duhet të vendosë për kërkesën, "*brenda 72 orëve nga paraqitja e përgjigjes ndaj ankesës ose nga skadimi i afatit për paraqitjen e përgjigjes [...]*". Kjo nënkupton rritje të afatit për vendosjen e ankesës nga 48 në 72 orë.<sup>47</sup>

### *Afatet e përcaktuara dhe shqyrtimi i paraburgimit*

Përdorimi i paraburgimit duhet të jetë proporcional. Kur paraburgimi shqiptohet për periudha të gjata, veçanërisht për vepra më të lehta, rriten shqetësimet lidhur me proporcionalitetin.

40 Neni 162(10), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

41 Nenet 185(4) dhe 164(2), *po aty*.

42 Neni 162(8) dhe 185(1) dhe (3) *po aty*.

43 Neni 162(9), *po aty*.

44 Neni 162(11), *po aty*, thotë se, brenda 48 orëve, gjyqtari i procedurës paraprake nxjerr "*vendim me të cilin vendos nëse i pandehuri do t'i nënshtrohet njëres prej masave nga neni 171*", përkatësisht, cilëso prej masave të autorizuara për të siguruar praninë e të pandehurit, duke e zëvendësuar përmendjen specifike vetëm me paraburgimin.

45 Neni 186(3), *po aty*.

46 Neni 189(3), Kodi i Procedurës Penale, 28 dhjetor 2012.

47 Neni 186(3), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

Urdhri fillestar për paraburgim duhet të jetë për periudhë maksimale prej një muaji nga dita e arrestimit.<sup>48</sup>

Para ngritjes së aktakuzës, KPP parasheh afatet për paraburgimin.<sup>49</sup> Afatet përcaktohen nga kohëzgjatja e burgimit në dispozicion për veprën e pretenduar. Për një vepër të dënueshme me burgim deri në pesë vjet, afati është katër muaj.<sup>50</sup> Nëse vepra parasheh dënim më të lartë se pesë vjet burgim, afati është tetë muaj. Në rastin e këtij të fundit, afati mund të zgjatet deri në katër muaj shtesë për “rastet e jashtëzakonshme” por vetëm kur vonesa nuk i atribuohet prokurorisë. Një zgjatje e mëtejshme deri në gjashtë muaj (d.m.th. deri në një total prej 18 muajsh) është e mundshme nëse ka arsye për të besuar se lirimi i të pandehurit mund të krijojë rrezik për dhunë ose rrezik publik.

Pas ngritjes së aktakuzës, nuk ka kufizime kohore për paraburgimin. Krahasuar me juridiksionet e tjera, kjo nuk është e paprecedentë. Megjithatë, vlen të theksohet se shumica e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian zgjedhin të vendosin kufizime të caktuara kohore për paraburgimin pas ngritjes së aktakuzës.<sup>51</sup>

Pas ngritjes së aktakuzës, paraburgimi duhet të shqyrtohet nga gjykata çdo dy muaj, edhe në rast se palët nuk kanë bërë ndonjë parashtrësë.<sup>52</sup> Gjatë shqyrtimit në fjalë, gjykata është e obliguar të dëgjojë mendimet e avokatit mbrojtës dhe të prokurorisë (nëse parashtrojnë parashtrësë) dhe të konstatojë nëse arsyet e paraburgimit mbeten të vlefshme. Palët gjithashtu kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit të gjykatës në të njëjtën mënyrë si ndaj çdo vendimi mbi paraburgimin.<sup>53</sup>

Krahas kësaj, KPP krijon një detyrë të përgjithshme që

*“paraburgimi duhet të zgjasë sa më shkurtë që është e mundur. Kur i pandehuri gjendet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme.”<sup>54</sup>*

Për më tepër, *“paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij”.*<sup>55</sup>

48 Neni 187, *po aty*.

49 Neni 187, *po aty*.

50 Këto afate kohore janë shqyrtuar së fundi nga Gjykata Kushtetuese në lëndën nr. K185/22, parashtruesi Jadran Kostiq dhe lënda nr. KI55/22, parashtruesi Sasha Spasiq.

51 Shih Rekomandimin e Komisionit Evropian për të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe personave të akuzuar që i nënshtrohen paraburgimit dhe për kushtet materiale të paraburgimit C (2022)8987 të datës 8 dhjetor 2022, paragrafi 14, që gjendet në [https://commission.europa.eu/system/files/2022-12/1\\_1\\_201158\\_rec\\_pro\\_det\\_en.pdf](https://commission.europa.eu/system/files/2022-12/1_1_201158_rec_pro_det_en.pdf) (shikuar së fundi më 18 korrik 2023).

52 Brenda komunitetit të profesionistëve të drejtësisë ka debat nëse kërkohet seancë kur zgjatet paraburgimi pas aktakuzës sipas nenit. 190 i KPP (dhe versioni në gjuhën shqipe nuk është përkthim fjalë për fjalë i versionit anglisht të KPP-së). Mundësisht, kjo paqartësi duhet të sqarohet në ndryshimet në KPP.

53 Neni 190(2) dhe neni 186(3) dhe (4), *po aty*.

54 Neni 182(2), *po aty*.

55 Neni 182(3), *po aty*.


## 4. MONITORIMI I GJYKIMEVE: ANALIZË STATISTIKORE DHE SHEMBUJ TË RASTEVE

### 4.1 Planifikimi i rasteve dhe gjetjet paraprake

#### *Seancat gjyqësore dhe të pandehurit*

Për qëllime të këtij raporti, OSBE-ja ka monitoruar 70 raste me 96 të pandehur gjatë periudhës 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2022. Janë monitoruar seanca në të shtatë gjykatat themelore si vijon:

Lëndet dhe të pandehurit e monitoruar sipas Gjykatës Themelore



**Figura 3.** Raste dhe pandehur të monitoruar sipas Gjykatave Themelore


Nga gjithsej 96 të pandehur, vetëm 5 (5 për qind) ishin gra. Dhjetë të pandehur (10 për qind) ishin nga komunitetet joshumicë dhe katër të pandehur (4 për qind) ishin të huaj, gjegjësisht nuk ishin nga Kosova.<sup>56</sup>

Për shkak të numrit të vogël të të pandehurve nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe grave, nuk është e mundur të nxirren përfundime të besueshme për trajtimin e mundshëm ndryshe për shkak të gjinisë apo komunitetit.

Seancat e monitoruara përfshinin një spektër të gjerë shkeljesh të pretenduara, duke filluar nga rrezikimi i komunikacionit publik e deri te vrasjet.

<sup>56</sup> Të pandehurit nga komunitetet joshumicë ishin: shtatë serbë të Kosovës, një boshnjak i Kosovës, një egjiptian dhe një rom, që të dy të Kosovës.

## Veprat e supozuara në seancat e monitoruara të paraburgimit për të pandehur



**Figura 4.** Veprat kryesore të pretenduara (për secilin të pandehur) në seancat e monitoruara të paraburgimit

### Respektimi i afateve dhe përfaqësimi i mbrojtjes

OSBE-ja vlerësoi pajtueshmërinë me kriteret procedurale, duke përfshirë afatet procedurale dhe përfaqësimin e mbrojtjes.

Në të gjitha rastet e monitoruara, afatet procedurale duke përfshirë edhe afatin për paraqitjen e kërkesës nga prokuroria,<sup>57</sup> si dhe afati brenda të cilit do të mbahet seanca janë respektuar.<sup>58</sup> Kjo është gjetje pozitive që tregon përparim të rëndësishëm nga raportimi i fundit i OSBE-së për këtë çështje.<sup>59</sup> Gjithashtu, të gjithë të pandehurit kanë përfituar nga përfaqësimi ligjor në përputhje me KPP-në.<sup>60</sup> Seancat u zhvilluan në prani të prokurorit dhe avokatit mbrojtës, siç parashihet nga KPP-ja.

### Rezultati i seancave dhe përdorimi i masave më të buta

Masa më të buta u kërkuan nga prokuroria vetëm në dy nga 70 rastet që janë analizuar për qëllime të këtij raporti – për dy nga 96 të pandehurit (dy për qind). Në të dyja këto raste, prokurori propozoi masën e arrestit shtëpiak për të siguruar praninë e të pandehurit.

57 Në kohën e kryerjes së analizës, ky afat kohor ishte 24 orë në përputhje me nenin 164(7), Kodi i Procedurës Penale, 28 dhjetor 2012.  
58 Neni 29 i Kushtetutës dhe neni 162(8) i Kodit të Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

59 Raporti i OSBE-së 'Shqyrtim i Zbatimit të Kodit të Ri të Procedurës Penale të Kosovës - qershor 2016' gjeti se, "Në praktikë, prokurorët përgjithësisht përmbushin afatin e ri 24-orësh të përcaktuar në nenin 164(7) të KPP-së. Gjithsej, 72 për qind e avokatëve janë përgjigjur se prokurorët "rrallëherë ose asnjëherë" nuk arrijnë të paraqesin kërkesë për paraburgim brenda 24 orëve pas arrestit, dhe 87 për qind e gjyqtarëve janë përgjigjur njëjtë." Shih faqen 30. Në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/243976> (qasur më 18 korrik 2023).

60 Neni 185(4), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022, sa herë që i pandehuri ndalohet, rasti bëhet mbrojtje e detyrueshme (pavarësisht nga kriteret e tjera). Prandaj, nëse i pandehuri nuk angazhon mbrojtësin e tij, duhet të caktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Rastet janë ndjekur nga e njëjta Prokurori Themelore dhe në të dyja rastet gjyqtari i procedurës paraprake e ka pranuar propozimin.

Në 68 rastet e tjera (për 94 të pandehur), prokuroria e ka kërkuar masën e paraburgimit. Vetëm në gjashtë nga ato raste kundër nëntë të pandehurve (10 për qind, 1 grua), gjykata e ka refuzuar këtë kërkesë dhe në vend të kësaj ka caktuar masa më të buta.

Kur kërkesa për caktimin e paraburgimit është refuzuar, janë shqiptuar masa më të buta, duke përfshirë arrestin shtëpiak (shtatë të pandehur), paraqitjen në stacionin policor (një i pandehur) dhe ndalimin për t'iu afruar vendit ose personit së bashku me paraqitjen në stacionin policor (një i pandehur).

Kodi i Procedurës Penale përcakton "masa më të buta" për të siguruar praninë e të pandehurit në gjykim. Këto përkufizohen si, *"thirrja; premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar; paraqitja në stacionin policor; dorëzania ose arresti shtëpiak."*<sup>61</sup> Ndonëse masat më të buta paraqesin kufizim më të vogël të lirisë së të pandehurit, ato megjithatë ndërhyjnë në të drejtat e tij/saj. Prandaj, edhe kur shqipton masa më të buta, gjykata duhet ta bëjë këtë vetëm në përputhje me ligjin në fuqi dhe kur është e nevojshme dhe proporcionale për të përmbushur një shqetësim legjitim (arratisja, kryerja e veprave tjera penale ose ndërhyrja në rrjedhën e drejtësisë).

Një ndryshim i paraqitur në KPP-në e vitit 2023 është heqja e "diversitetit" si masë e mundshme më e butë.<sup>62</sup> Megjithatë, monitorimi i gjykimeve nga OSBE-ja tregon se diversiteti është përdorur rrallë para këtij ndryshim-plotësimi. Në të vërtetë, ajo nuk është shqiptuar në asnjë rast që është monitoruar nga OSBE-ja në dy vitet e fundit.


Në përgjithësi, kërkesat për paraburgim janë miratuar në shumicën e rasteve. Aty ku u përdoren "masa më të buta", masa më e zakonshme e shqiptuar ishte ajo e arrestit shtëpiak (si masa më kufizuese nga "masat më të buta" në dispozicion).

Këto statistika janë kryesisht të ngjashme me ato që janë marrë nga monitorimi i gjykimeve nga OSBE-ja në vitin 2021. Në vitin 2021, nga 140 të pandehur (në 89 seanca) vetëm 22 (16 për qind) u liruan me "masa më të buta". Nga këta 22 të pandehur, 21 u liruan nën masën e arrestit shtëpiak dhe një i pandehur u lirua nën masën e paraqitjes në stacion policor.

61 Neni 171(5), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

62 Neni 173(1.8) dhe neni 184, Kodi i Procedurës Penale, 28 dhjetor 2012.

## Masat e shqiptuara pas seancave që janë monitoruar



**Figura 5.** Përqindjet e masave që janë shqiptuar pas seancave dëgjimore që janë monitoruar nga OSBE.

### 4.2 Shembuj të rasteve

#### 4.2.1 Dështimi i prokurorëve për të siguruar prova të dyshimit të bazuar

Siç është përshkruar më lart, kërkesa e prokurorit për caktimin e paraburgimit duhet të përfshijë përshkrimin e provave që mbështesin dyshimin e bazuar se personi i arrestuar ka kryer veprën e dyshuar penale.<sup>63</sup>

Të gjitha kërkesat e analizuar për këtë raport e kanë theksuar ekzistimin e dyshimit të bazuar. Kjo zakonisht vërtetohet përmes listës së provave që janë mbledhur deri atëherë në rast.

Megjithatë, në disa raste, OSBE-ja ka vlerësuar se prokuroria nuk e ka përshkruar në mënyrë të duhur bazën e supozuar për konstatimin e dyshimit të bazuar. Ky ishte shqetësim i veçantë në rastet me shumë të pandehur dhe ku të pandehurit akuzoheshin për "bashkëkryerje". Në këto raste, OSBE-ja gjeti se ndërsa prokuroria i ka cituar provat për të vërtetuar se vepra kishte ndodhur, ajo shpesh nuk e kishte saktësuar përfshirjen/rolin e secilit të pandehur apo se si një gjë e tillë u vërtetua nga provat.

Për shembull:

Në një rast në Gjykatën Themelore të Gjilanit ku ishin të përfshirë nëntë të pandehur, njëri i pandehur ishte akuzuar për veprën e mashtrimit,<sup>64</sup> dhe tetë të pandehurit e tjerë ishin akuzuar për rrëmbimin e të pandehurit të parë.<sup>65</sup> Në

<sup>63</sup> Neni 163(2,4), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

<sup>64</sup> Neni 323(1) i Kodit nr. 06/L-074 Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;

<sup>65</sup> Neni 191 (2) dhe (2.2) në lidhje me nenin 31, *po aty*; .

kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit thuhej thjesht se tetë të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer rrëmbimin, me një përshkrim të përgjithshëm të ngjarjes. Kërkesa nuk saktësonte apo vërtetonte se si veprimet e pretenduara të secilit të pandehur, veç e veç, kontribuuan për kryerjen e veprës penale të rrëmbimit, *d.m.th.* kërkesa nuk tregonte qartë veprimet dhe rolet e veçanta të pretenduara të secilit të pandehur veç e veç në kryerjen e veprës penale. Gjithashtu, në kërkesë nuk është përmendur asnjë individualizim apo tregues për veprime të veçanta inkriminuese për të përmbushur kriteret e dyshimit të bazuar. Megjithatë, gjyqtari i procedurës paraprake e miratoi kërkesën dhe për të nëntë të pandehurit shqiptoi masën e paraburgimit.

Në një rast në Departamentin Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës, një i pandehur është akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë<sup>66</sup> në lidhje me veprën penale të pjesëmarrjes ose organizimit të një grupi të organizuar kriminal.<sup>67</sup> Sipas kërkesës për caktimin e paraburgimit, i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën e vrasjes si anëtar i grupit të organizuar kriminal, duke vepruar së bashku me persona të tjerë "duke vepruar në role të paracaktuara dhe për një periudhë të gjatë kohore me qëllim të kryerjes së veprave penale". Megjithatë, kërkesa rezultoi e paqartë dhe i mungonte arsyetimi i veçantë, duke e bërë të paqartë atë se si prokuroria e arsyetonte ekzistencën e "dyshimit të bazuar". Në veçanti, kërkesa ofronte vetëm një përshkrim të përgjithshëm të veprimeve të pretenduara të të pandehurit dhe nuk saktësonte se si ai kishte kontribuar në kryerjen e veprave të pretenduara penale.

Seanca e paraburgimit nuk është gjykim – prokuroria nuk pritet që të provojë veprat e pretenduara sipas standardit të provës që kërkohet për ta dënuar dikë. Megjithatë, gjyqtari i procedurës paraprake duhet të jetë i bindur se ka prova të mjaftueshme të pranueshme kundër të pandehurit për të vërtetuar "dyshimin e bazuar" kundër secilit të pandehur veç e veç.

OSBE-ja gjithashtu vuri në dukje se shqetësimet në lidhje me kërkesat e prokurorisë shpesh pasqyroheshin në vendimet e gjykatës, pasi gjyqtarët e procedurës paraprake pranuan arsyetimet e pamjaftueshme të prokurorisë pa kërkuar informacion shtesë.

Arsyetimi i pamjaftueshëm në kërkesat e prokurorisë për paraburgim ndikon edhe në cilësinë e mbrojtjes. Më konkretisht, është më e vështirë për mbrojtjen që të përgatisë dhe atakojë kërkesat për paraburgim me kërkesa të paqarta ose të paarsyeshme.

#### 4.2.2. Dështimi i prokurorëve për të arsyetuar ose individualizuar kërkesat për paraburgim

Analiza e kërkesave të prokurorisë për paraburgim tregoi se prokurorët shpesh përmendin dy ose më shumë arsye për paraburgim. Megjithatë, OSBE-ja gjeti se kërkesat shpesh dështuan që të sigurojnë "*përshkrim të mjaftueshëm të provave që mbështesin bazat e artikuleshme*" siç përcaktohet nga KPP-ja.<sup>68</sup>

66 Neni 179 (1.9) i Kodit Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Kosovës, 13 korrik 2012;

67 Neni 283 (3) dhe (1), *po aty*;


68 Neni 163(2.5), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022;

Zbatimi e çdo baze duhet të shqyrtohet me kujdes bazuar në rrethanat e rastit dhe të të pandehurit. Megjithatë, shqetësimi kryesor i identifikuar nga monitorimi është se kërkesat e prokurorisë shpesh pohojnë baza pa i lidhur ato në mënyrë të qartë me faktet e pretenduara të rastit dhe/ose rrethanat e të pandehurit. Në praktikë, kërkesat e analizuara shpesh kanë rezultuar të jenë të paqarta, teorike, abstrakte ose shabllone dhe me mungesë të arsyeve bindëse dhe të sakta se përse çdo i pandehuri duhet të privohet nga liria.

Arsyetimet e përgjithshme ose abstrakte ishin veçanërisht të zakonshme në lidhje me rrezikun e arratisjes dhe rrezikun e ndërhyrjes në prova ose të ndikimit në dëshmitarë.

Grafiku i mëposhtëm tregon zbërthimin e analizës së monitorimit të gjykimeve të kërkesave të prokurorisë. Në mënyrë domethënëse, në më shumë se 60 për qind të rasteve, OSBE-ja vuri në dukje disa ose shqetësime serioze në lidhje me standardin e kërkesave të prokurorisë.

### Vlerësim i Kërkesave të Prokurorisë për Paraburgim



**Figura 6.** Vlerësimi i kërkesave të prokurorisë për caktimin e paraburgimit

Ilustrim i disa nga shqetësimet e identifikuar nga OSBE-ja:

Për shembull, në një rast që përfshin pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve<sup>69</sup> pranë Gjykatës Themelore në Prizren, prokurori argumentoi se ekzistonte rreziku i arratisjes me pohimin e përgjithshëm se “kufijtë mund të kalohen lehtë”. Nuk u përshkrua asnjë arsye se pse i pandehuri i caktuar mund të paraqiste rrezik të fshehjes ose arratisjes nga juridiksioni. Arsyeja tjetër e cekur është se vepra penale në fjalë është në rritje në Kosovë dhe kjo mund ta shtyjë të pandehurin që ta përsërisë veprën penale ose të kryejë vepër tjetër penale. Në të njëjtën kohë është sekuestruar arma, objekt i veprës penale. Ky është arsyetim i përgjithshëm, që nuk është i mbështetur në të kaluarën e të pandehurit apo rrethanat e tij personale. Në të vërtetë, gjykata e hodhi poshtë këtë bazë pasi arma ishte konfiskuar dhe rrjedhimisht rreziku i përsëritjes së

<sup>69</sup> Neni 366(2), Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;



veprës penale nuk ekzistonte më. Gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi se masa e paraqitjes në stacion policor do të ishte më e përshtatshme.

Në një rast që ka të bëjë me veprat penale të rrezikimit të komunikacionit publik<sup>70</sup> dhe mosdhënies së ndihmës për personin e lënduar në një aksident trafiku publik<sup>71</sup> në Gjykatën Themelore në Pejë, prokurori e arsyetoi kërkesën për paraburgim me bazën se ekzistonte rreziku u arratisjes nga i pandehuri. Kjo pasi i pandehuri nuk kishte ofruar ndihmë pas aksidentit dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes. Megjithatë, gjykata me sa duket nuk i ka peshuar të gjitha rrethanat përkatëse në vendim. I pandehuri u arrestua në shtëpinë e tij disa orë pas incidentit (duke sugjeruar se nuk kishte qëllim për t'u arratisur nga juridiksioni). Gjykata në këtë rast ka caktuar masën e paraburgimit, ndonëse vepra mund të konsiderohet se ishte e lehtë.

Një gjë brengosëse e gjetur nga OSBE-ja është se arsyetimi i dhënë në lidhje me rrezikun e arratisjes shpesh bazohej vetëm në kohëzgjatjen e dënimit të mundshëm nëse personi do të dënohej (shih shembullin më poshtë). Në bazë të udhëzimeve të GJEDNJ-së, ashpërsia e dënimit të mundshëm nuk mund të jetë baza e vetme për të pohuar se ekziston rreziku i arratisjes. Ekzistimi i këtij rreziku duhet të vlerësohet së bashku me rrethanat tjera përkatëse. Ky argument ishte relativisht i zakonshëm në rastet që janë monitoruar.

Në një rast pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, me tre të pandehur të akuzuar për vepra të lidhura me drogat,<sup>72</sup> kërkesa për paraburgim përmbante baza të përgjithshme për të tre të pandehurit që arsyetonin rrezikun e arratisjes dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Prokurori e arsyetoi ekzistimin e rrezikut të arratisjes për të tre të pandehurit vetëm me kohëzgjatjen e dënimit të paraparë për veprën. Prokurori e konstatoi qëllimin e të gjithë të pandehurve për të përsëritur veprën bazuar vetëm në sasinë e lëndës narkotike që ishte sekuestruar. Këto dy baza nuk u arsyetuan për secilin të pandehur individualisht dhe kërkesa nuk i referohej rrethanave personale të secilit të pandehur në arsyetimin e saj. Gjykata megjithatë e urdhëroi masën e paraburgimit.

Në një rast në Gjykatën Themelore të Prizrenit, ku ishte i përfshirë një i pandehur i dyshuar për vepër penale me armë,<sup>73</sup> dhe i pandehuri i dytë i dyshuar për kryerjen e veprës penale lëndim i lehtë trupor,<sup>74</sup> prokurori nuk paraqiti argumente të individualizuara për secilin të pandehur. Në vend të kësaj, u dhanë vetëm arsyetime të përgjithshme për caktimin e paraburgimit, bazuar në rreziqet e arratisjes dhe përsëritjes së veprës penale. Për rrezikun e arratisjes, arsyetimi për të dy të pandehurit ishte "kalimi i lehtë i kufirit" dhe dënimet e mundshme për veprat penale. Rreziku i përsëritjes së veprës penale ishte i arsyetuar në mënyrë përfundimtare, për atë se të pandehurit kishin një mosmarrëveshje lidhur me pronën e tyre.

Në përgjithësi, OSBE-ja gjeti shqetësime më serioze në rastet që përfshinin të pandehur të shumtë, pasi prokurorët shpesh dështuan që të paraqesin në hollësi bazat e paraburgimit dhe mënyrën se si ato lidhen me secilin të pandehur. Një "individualizim" i tillë i kërkesave është jetik

70 Neni 370(2), *po aty*;

71 Neni 374(1), *po aty*;

72 Neni 267(2) në lidhje me nenin 31, *po aty*;

73 Përkatësisht, nenet 366(1) dhe 367(2), *po aty*;

74 Neni 185 (1,1) dhe (2), *po aty*;

për të mbrojtur të drejtën e lirisë së të akuzuarit dhe për të siguruar që paraburgimi të arsyetohet për secilin të pandehur.

Megjithatë, OSBE-ja vëren se ka edhe shembuj të praktikave të mira, ku prokurorët arsyetuan mjaftueshëm bazat për paraburgim dhe i përshtatën ato enkas me rrethanat e rastit dhe të pandehurit:

Në një rast të pretenduar të dhunës në familje në Gjykatën Themelore në Gjilan,<sup>75</sup> prokurori shtjelloi dhe arsyetoi mirë bazat për caktimin e paraburgimit, duke ia përshtatur enkas rrethanave të rastit, marrëdhënieve mes të pandehurit dhe të dëmtuarit dhe sjelljes së të pandehurit. Duke përdorur deklaratën e të dëmtuarit dhe deklaratën e një dëshmitari, fotografitë e lëndimeve dhe raportin mjekësor, prokurori e mbështeti pohimin e dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprë penale.

#### 4.2.3 Dështimi i prokurorëve për të saktësuar se përse masat alternative nuk mund të sigurojnë praninë e të pandehurit në gjykim

Kërkesa e prokurorisë për paraburgim duhet të përfshijë *“përshkrimin e bazave të artikuleshme që bëjnë të besohet se masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të pamjaftueshme”*.<sup>76</sup> Në kërkesat e analizuara për këtë raport, prokuroria e ka cekur këtë kriter. Zakonisht ai shoqërohej me një pohim se prokuroria i kishte vlerësuar *“masat më të buta”*, por i kishte konsideruar ato të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo pengimin e drejtësisë.

OSBE-ja vëren se shumë kërkesave të prokurorisë u mungon analiza apo shpjegimi se pse masat më të buta janë të pamjaftueshme për të përmbushur këto shqetësime. Prandaj, është e vështirë që të vlerësohet nëse i është kushtuar konsideratë e duhur ekzistimit të alternativave përpara se të kërkohet paraburgimi.

Përdorimi i paraburgimit duhet të jetë në proporcion me rrezikun e paraqitur nga i pandehuri në lidhje me bazat e përcaktuara në KPP. Nëse masat më të buta mund ta mbulojnë këtë rrezik, atyre duhet t’u jepet prioritet ndaj paraburgimit. Thënë shkurt, paraburgimi duhet të jetë gjithmonë masë e fundit. Prokurorët duhet ta arsyetojnë më shumë shqyrtimin e masave më të buta dhe pse ato janë të pamjaftueshme.

#### 4.2.4 Dështimi i avokatëve mbrojtës për t’i atakuar në mënyrë adekuate kërkesat për paraburgim ose për të propozuar masa më pak kufizuese

Sa herë që i pandehuri ndalohej, por edhe në seancën e paraburgimit, përfaqësimi nga avokati mbrojtës është i detyrueshëm.<sup>77</sup> Prandaj, nëse i pandehuri nuk e angazhon avokatin e vet

<sup>75</sup> I pandehuri u akuzua sipas nenit 185, *po aty*;

<sup>76</sup> Neni 163(2.6), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

<sup>77</sup> Neni 185 (3) dhe (4), *po aty*;

privatisht, atij/asaj duhet t'i caktohet avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare, pavarësisht nga mundësitë.

Në seancat e monitoruara OSBE-ja ka vërejtur se të gjithë të pandehurit ishin të përfaqësuar. Nga 96 të pandehur, 58 u përfaqësuan me avokatë të caktuar sipas detyrës zyrtare (60 për qind).

Avokati mbrojtës luan rol të rëndësishëm në kundërshtimin e kërkesave të prokurorisë për paraburgim dhe në mbrojtjen e të drejtës së individit për liri.

Siç u diskutua më lart, dyshimi i bazuar është parakusht për paraburgim. Mbrojtjes duhet t'i dorëzohen hollësi të mjaftueshme të pretendimit dhe prova për të vlerësuar nëse ekziston dyshimi i bazuar. Për më tepër, ata duhet të jenë të përgatitur për ta atakuar këtë pohim dhe për të ngritur çdo shqetësim procedural (shkelje të afateve, parregullsi në mbledhjen e provave, etj.) gjatë seancës për caktim të paraburgimit.


Përveç kundërshtimit të argumenteve të paraqitura në favor të paraburgimit, avokatët mbrojtës janë në pozitë unike për t'i adresuar në gjykatë rrethanat personale të të pandehurit. Rrethanat si lidhjet e forta me komunitetin, punësimi, detyrimet familjare, gjendja mjekësore, imazhi i mirë, bashkëpunimi në procedura deri në atë kohë (përfshirë rastet e mëparshme) dhe mundësia e "dorëzaniës" mund të paraqiten për të bindur gjykatën se nuk janë plotësuar kushtet për paraburgim.

Mbrojtja duhet gjithashtu të jetë proaktive në shqyrtimin dhe propozimin e masave më të lehta si alternativë ndaj paraburgimit. Në disa raste, avokati mbrojtës mund të kërkojë edhe të negociojë me prokurorin për të rënë dakord për masa më të buta përpara seancës për paraburgimin. Qëndrimi proaktiv e realist, që ofron masa më të buta të përshtatshme, është shpesh qasja më bindëse për të siguruar lirim nga paraburgimi.

Në rastet e monitoruara për këtë raport, avokatët mbrojtës kanë sugjeruar "masa më të buta" si alternativë ndaj paraburgimit në 81 për qind të rasteve. Arresti shtëpiak ishte "masa më e butë" e propozuar më së shpeshti, pasuar nga paraqitja në stacionin policor si dhe ndalimi i afrimit me një vend apo person të caktuar. OSBE-ja vëren se "dorëzania" merret parasysh shumë rrallë.<sup>78</sup>

78 Neni 179, po aty, thekson se lirim me dorëzani, "gjithmonë përkufizohet si shumë e parave e përcaktuar sipas peshës së veprës penale, rrethanave personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që e jep dorëzaniën." Sipas nenit 177, dorëzania mund të përdoret edhe për ta adresuar rrezikun ndaj ikjes.

## Masat e Propozuara nga Avokatët Mbrojtës në Seancat e Monitoruara të Caktimit të Paraburgimit



**Figura 7.** Masat e propozuara nga avokatët mbrojtës në seancat e monitoruara për caktim të paraburgimit<sup>79</sup>

Në përgjithësi, monitoruesit kanë vlerësuar punën e avokatëve mbrojtës si të mjaftueshme ose të mirë. Megjithatë, kishte brenga serioze për cilësinë e përfaqësimit për 25 nga 96 të pandehur (26 për qind); ndërkohë që janë vërejtur disa shqetësime për përfaqësimin e 18 të pandehurve të tjerë (19 për qind). Shqetësimet lidhen kryesisht me dështimin e avokatit mbrojtës për të kundërshtuar arsyet e paraburgimit ose dështimin për të propozuar masa më të buta kur është e përshtatshme.

Sa për ilustrim:

Në një rast në Gjykatën Themelore të Prishtinës që përfshinte dy të pandehur të akuzuar për dhunë në familje,<sup>80</sup> OSBE-ja vërejti se të dy avokatët nuk arritën t'i kundërshtonin parashtresat e prokurorit, ofruan argumente shumë të përgjithshme në favor të lirimit nga paraburgimi dhe nuk propozuan ndonjë masë më të butë – ndonëse kishte masa më të buta që do të kishin qenë relevante dhe do të mund t'i përgjigjeshin brengave të tilla. Këto përfshinin ndalimin për t'iu afruar një vendi të caktuar, personi ose arresti shtëpiak, duke pasur parasysh se të pandehurit kishin sulmuar njëri-tjetrin. Të dy të pandehurve gjykata caktoi masën e paraburgimit.

Në një rast në Gjykatën Themelore të Ferizajt, i cili kishte të bënte me veprën e grabitjes,<sup>81</sup> avokati mbrojtës e kundërshtoi kërkesën për caktimin e paraburgimit, duke deklaruar se nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e paraburgimit, por pa ofruar arsye konkrete apo propozim të masës alternative më të butë.

<sup>79</sup> Në nenin 171(5), *po aty*, masat më të vogla përkufizohen si: "thirrjet; premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar; paraqitja në stacionin policor; dorëzania; arresti shtëpiak". Vini re që statistikën në këtë figurë përfaqësojnë numrin e përgjithshëm të herave që një masë është propozuar; shpesh avokatët mbrojtës propozonin më shumë se një masë

<sup>80</sup> Neni 248(3) (3.1) (3.2), Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;

<sup>81</sup> Neni 317(3), *po aty*;

Në një rast tjetër në Gjykatën Themelore të Gjakovës, ku bëhej fjalë për pesë të pandehur të akuzuar për veprën penale të fajdesë,<sup>82</sup> mbrojtësi i njërit prej të pandehurve deklaroi se nuk i kishte të gjitha dokumentet e nevojshme për mbrojtje të mirëfilltë. Megjithatë, ai gjithsesi vazhdoi të kundërshtojë kërkesën. Duke vepruar kështu, ai u përpoq të adresonte njërin nga shqetësimet - frikën e ikjes - duke pohuar se klienti i tij kishte premtuar se do të bashkëpunonte, por nuk arriti të adresonte bazat tjera të pretenduara nga prokuroria. Avokati nuk i kërkoi gjykatës t'i siguronte atij dokumentet apo kohë shtesë për t'i shqyrtuar ato dokumente dhe për t'i përgatitur. Në këtë rast, gjykata e caktoi masën e paraburgimit.

Vlen të përmendet se OSBE-ja vërejti më pak brenga në lidhje me avokatët mbrojtës të angazhuar privatisht sesa ata të caktuar sipas *detyrës zyrtare*.<sup>83</sup> Kjo mund të ketë qenë për shkak se avokatët e angazhuar privatisht ishin më të njohur me rastin dhe/ose kishin më shumë kohë për t'u përgatitur për të përfaqësuar klientët e tyre.

Në vijim është dhënë një shembull i një praktike të mirë nga avokati mbrojtës:

Në një rast në Gjykatën Themelore të Prishtinës që përfshinte një të pandehur të akuzuar për kryerjen e veprave penale me armë,<sup>84</sup> avokati mbrojtës i angazhuar privatisht paraqiti parashtresë gjithëpërfshirëse, duke kundërshtuar kërkesën për paraburgim ndaj klientit të tij. Avokati mbrojtës kundërshtoi versionin e prokurorit për ngjarjet, duke hedhur poshtë faktin se i pandehuri kishte armë me vete ditën e arrestimit dhe me këtë bazë goditi dyshimin e bazuar. Së dyti, avokati mbrojtës deklaroi se nuk ka rrezik të ikjes nga i pandehuri, pasi ai nuk kishte ikur nga vendi i ngjarjes, si dhe ka bashkëpunuar me policinë. Avokati mbrojtës propozoi arrestin shtëpiak si masë efektive dhe më pak kufizuese sesa paraburgimi.

#### 4.2.5 Dështimi i gjyqtarëve për të arsyetuar ose individualizuar mjaftueshëm vendimet për paraburgim

Sipas KPP-së, pas mbajtjes së seancës për caktimin e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake duhet të nxjerrë aktvendim që përmban: *"arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë kërkuar caktimin e paraburgimit, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer veprë penale dhe faktet vendimtare nga neni 184 [Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit]."*<sup>85</sup>

Analiza e rasteve të monitoruara tregon një prirje të madhe të gjykatave për të miratuar kërkesat e prokurorisë. Në fakt, gjykatat refuzuan kërkesat e prokurorisë në vetëm 9 raste nga 96 të pandehurit në rastet e analizuara (9 përqind, një grua).

82 Neni 331(2) në lidhje me nenin 31, po aty.

83 Në 31 nga 58 parashtresa nga avokatët mbrojtës të analizuara për raportin, janë vërejtur brenga në lidhje me performancën e avokatëve mbrojtës (53 për qind). Kjo krahasohet me raportin prej 10 nga 36 parashtresa nga avokatë të angazhuar privatisht (27 përqind).

84 Nenet 366(1) dhe 367(1), Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;


85 Neni 186(1), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

Në të gjitha rastet, përveç dy prej tyre, prokuroria kërkoi paraburgim në vend të masave më të buta. Me fjalë të tjera, masa më të buta janë shqiptuar vetëm ndaj 11 nga 96 të pandehurve (11 për qind) – për dy të pandehur kjo ishte në pajtim me kërkesën e prokurorisë.

Ndërkohë që kemi parasysh madhësinë relativisht të vogël të mostrës të studimit, përqindja e kërkesave të prokurorisë të refuzuara dhe të pandehurve të liruar me "masa më të buta", duket e ulët.<sup>86</sup> Kështu ndodh sidomos kur merret parasysh se masat më të buta duhet të vendosen nga gjykata dhe nuk mund të vendosen nga prokuroria/policia sipas detyrës zyrtare gjatë fazës së hetimit (ndryshe nga disa juridiksione të tjera).

Në analizimin e të gjitha vendimeve për paraburgim, OSBE-ja ka vërejtur brenga të caktuara, ose edhe shqetësime serioze në lidhje me cilësinë e arsytimit në vendimet për sa i përket 47 përqind të të pandehurve. Megjithatë, kur numërohen vetëm aktvendimet që kanë rezultuar me caktim të paraburgimit, përqindja është pak më e lartë, duke arritur në 52 për qind.

### Analiza e aktvendimeve në seancat e monitoruara



**Figura 8.** Analiza e vendimeve lidhur me seancat e monitoruara

Për sa i përket pranisë së dyshimit të bazuar, OSBE-ja vërejti se gjyqtarët e procedurës paraprake në përgjithësi renditnin provat dhe i krahasonin ato me faktet e pretenduara. Megjithatë, në rastet me shumë të pandehur, OSBE-ja ka vërejtur shqetësime. Në këto raste, vendimet nganjëherë nuk e përshkruanin rolin e pretenduar të secilit të pandehur, duke e bërë më pak të qartë ekzistencën e dyshimit të bazuar ndaj secilit individ. Kjo reflektonte shqetësime të ngjashme të gjetura nga OSBE-ja edhe në lidhje me kërkesat e prokurorisë.

OSBE-ja vuri në dukje se shumica e vendimeve përmbanin disa shqetësime në lidhje me standardin e arsytimit të dhënë nga gjyqtari i procedurës paraprake. Argumentet e paraqitura nga prokuroria u përsëritën shpesh fjalë për fjalë dhe për rrjedhojë shumë vendime u konstatuan të ishin të përgjithshme dhe/ose abstrakte. Një shqetësim tjetër i identifikuar ishte

<sup>86</sup> Për krahasim, shifrat nga Anglia dhe Uells tregojnë se në vitin që përfundon në qershor 2021, 20 për qind e të pandehurve të paraqitur në Gjykatën e Magjistratëve në paraburgim u liruan me kusht ose me dorëzani pa kushte, ndërsa në vitin që përfundon në qershor 2022, e njëjta shifër ishte 15%. Shih <https://www.gov.uk/government/statistics/criminal-justice-system-statistics-quarterly-june-2022/criminal-justice-statistics-quarterly-june-2022-html#remands> (qasur më 18 korrik 2023).

se disa vendime nuk ofronin analiza të detajuara e as shqyrtim të argumenteve të paraqitura nga mbrojtja, ose nuk trajtonin pse masat më të buta nuk do të mjaftonin. Përveç kësaj, aktvendimet shpeshherë nuk arrijnë të individualizojnë bazën për vendimin për paraburgimin.

Edhe kur paraburgimi është qartësisht i nevojshëm, gjykata duhet të japë arsyetim të mjaftueshëm dhe të artikuluar mirë për vendimin e saj. Aktvendimet duhet të trajtojnë argumentet e mbrojtjes, të marrin në konsideratë përshtatshmërinë e masave më të buta dhe të shpjegojnë pse masat e tilla janë të pamjaftueshme dhe pse paraburgimi është i domosdoshëm dhe proporcional.

Kriteri për nxjerrjen e një vendimi të qartë dhe të argumentuar mirë është njëlloj i zbatueshëm në rastet kur kërkesa e prokurorisë refuzohet dhe vendosen masa më të lehta ose mbrojtja në liri. Masat më të buta po ashtu paraqesin kufizim të lirisë dhe është e rëndësishme që aktvendimet të japin arsyetimin e mjaftueshëm për të vërtetuar se janë të domosdoshme dhe proporcionale përballë rrethanave të rastit dhe të pandehurit.

Megjithatë, OSBE-ja vëzhgoi raste kur gjyqtarët nuk arritën të arsyetojnë siç duhet aktvendimin për paraburgim ose të individualizojnë vendimet për secilin të pandehur.

Për shembull, në një rast në Gjykatën Themelore të Pejës, ku bëhej fjalë për një të pandehur të dyshuar për veprën penale lëndim i lehtë trupor,<sup>87</sup> gjyqtari i procedurës paraprake refuzoi kërkesën për caktimin e paraburgimit dhe caktoi masën e ndalimit të afërimit ndaj personit apo vendit të caktuar, së bashku me masën e paraqitjes në polici. Ky vendim u bazua në arsyetimin se këto dy masa do ta pengonin të pandehurin të ndikojë te dëshmitarë dhe të përsërisë veprën penale. Megjithatë, OSBE-ja vërejtë se ndonëse e refuzoi propozimin e prokurorisë, gjyqtari i procedurës paraprake nuk arriti të arsyetojë mirëfilli aktvendimin e tij. Përveç kësaj, OSBE-ja vërejtë se aktvendimi nuk i referohej bazës së rrezikut të ikjes së të pandehurit, dhe për këtë arsye dispozita e KPP-së për caktimin e masës së paraqitjes në stacion policor nuk ishte përmbushur.<sup>88</sup>

Në një rast që përfshinte veprën e fajdesë (i përmendur edhe më lart) që përfshinte pesë të pandehur në Gjykatën Themelore të Gjakovës, Gjykata Themelore nuk arriti të individualizojë arsyetimin për caktimin e paraburgimit ndaj secilit të pandehur. Në vend të kësaj, i njëjti arsyetim ishte dhënë për secilin të pandehur, pa dallim. Rreziku i arratisjes u arsyetua vetëm në bazë të dënimit maksimal për veprën e pretenduar (10 vjet burgim). Gjyqtari i procedurës paraprake gjithashtu konstatoi se ekzistonte rreziku i ndërhyrjes tek dëshmitarët/provat për shkak të afërsisë mes të pandehurve dhe dëshmitarëve, por nuk arriti të shpjegojë pse “masat më të buta” nuk do ta mbulonin këtë brengë. Më në fund, për të gjithë të pandehurit u konstatua se kishte rrezik për përsëritje të veprës, sepse disa (por jo të gjithë) kishin dënime të mëparshme. Vendimi ngriti shqetësime serioze për shkak të natyrës së tij të përgjithësuar dhe abstrakte, që e bëri të vështirë të kuptohej se pse ishte caktuar paraburgimi ndaj secilit të pandehur individual të ndarë nga grupi.

Në një rast në Gjykatën Themelore të Prishtinës, që bënte fjalë për akuza të pretenduara për mbajtje, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve dhe përdorim të armës ose instrumentit të rrezikshëm,<sup>89</sup> gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi se ishin plotësuar

87 Neni 185(1), Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;

88 Shih nenin 176(1.2), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.

89 Nenet 366(1) dhe 367(1), Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;

të tri kushtet për caktimin e paraburgimit, por nuk dha arsytim të mjaftueshëm për dy prej kushteve. Megjithatë, gjyqtari i procedurës paraprake ofroi argumente të arsyetuara në lidhje me rrezikun e përsëritjes së veprës.

Arsyetimi tepër i përgjithshëm dhe i pamjaftueshëm në aktvendimet gjyqësore cenon sigurinë juridike dhe pengon aftësinë e palëve për të kundërshtuar në mënyrë efektive vendimet përmes mjeteve juridike në dispozicion. Gjykata ka për detyrë të zbatojë dispozitat ligjore për rrethanat e rastit dhe të pandehurit, si dhe të arsyetojë mjaftueshëm vendimet e saj. Arsyetimi abstrakt ose i përgjithshëm në vendimin e paraburgimit do të mund të përbënte shkelje të së drejtës për liri.<sup>90</sup>

Megjithatë, OSBE-ja ka vëzhguar rastet kur gjyqtari i procedurës paraprake ka dhënë arsytim adekuat gjatë caktimit të paraburgimit:

Në një rast në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, prokuroria pretendonte se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale të sulmit ndaj personave zyrtarë<sup>91</sup>; kontrabandë me mallra<sup>92</sup> dhe vrasje në tentativë.<sup>93</sup> Gjyqtari i procedurës paraprake nuk e pranoi propozimin e prokurorit se i pandehuri ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë. Në vend të kësaj, aktvendimi thotë se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale sulm ndaj personave zyrtarë dhe kontrabandë me mallra, bazuar në provat e siguruara në shkresat e lëndës. Për më tepër, gjyqtari refuzoi arsyetimin lidhur me rrezikun e ndërhyrjes në prova, për shkak se prokurori nuk kishte vërtetuar se i pandehuri mund ta bëjë këtë. Këtu gjyqtari i procedurës paraprake i analizoi kërkesat për paraburgim në mënyrë të hollësishme dhe bazuar në faktet dhe rrethanat specifike të rastit.

#### 4.2.6 Mospërmbushja e afateve procedurale nga Gjykata e Apelit

Raporti i OSBE-së i vitit 2016 “Rishikimi i zbatimit të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës” konstatoi se avokatët mbrojtës dhe prokurorët kishin raportuar se Gjykata e Apelit shpesh nuk e respekton afatin kohor prej 48 orësh për të vendosur ankesat kundër vendimeve për paraburgim.<sup>94</sup>

Me KPP-në e ri (në fuqi nga shkurti 2023), afati për Gjykatën e Apelit është shtyrë në 72 orë nga parashtrimi i përgjigjes në ankesë.<sup>95</sup> Kjo dispozitë e re zgjat edhe kohën në dispozicion të palëve për të bërë ankesë nga 24 në 48 orë. Pas kësaj, i padituri ka 24 orë për të parashtruar përgjigjen. Pas parashtrimit të përgjigjes ose pas skadimit të afatit 24 orësh, Gjykata e Apelit ka 72 orë për të vendosur ankesën dhe për të marrë vendim. Kjo arrin në një afat maksimal prej gjashtë ditësh (144 orë) brenda së cilës duhet të bëhet ankesa.

Megjithatë, në shtatë raste të monitoruara nga OSBE-ja mes shkurtit 2023 dhe majit 2023, koha mesatare e kaluar për të nxjerrë vendim për ankesë ishte 17 ditë, njëmbëdhjetë (11) ditë më

90 Shiko S., V. dhe A. kundër Danimarkës, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i datës 22 tetor 2018, para. 92.

91 Neni 402 (2) me (6), Kodi Penal i Kosovës, 14 janar 2019;

92 Neni 311(1), *po aty*;

93 Neni 172 në lidhje me nenin 28, *po aty*;


94 Faqe 30, gjendet tek <https://www.osce.org/kosovo/243976> (qasur më 18 korrik 2023).

95 Neni 186(3), Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022.



shumë se koha e lejuar sipas afateve të lartpërmendura. Prandaj, duket se shqetësimet e ngritura në raportin e OSBE-së për vitin 2016 mbeten të vlefshme.

### Numri i ditëve ndërmjet aktvendimit të gjykatës themelore për paraburgim dhe aktvendimeve të Gjykatës së Apelit në rastet e monitoruara që nga 17 shkurti 2023



**Figura 9.** Numri i ditëve ndërmjet aktvendimit të Gjykatës Themelore për paraburgim dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit në rastet e monitoruara që nga 17 shkurti 2023

Lidhur me vendimet substanciale të Gjykatës së Apelit, OSBE-ja ka analizuar nëntë aktvendime të nxjerra nga dhjetori 2022 deri në maj 2023 dhe ka theksuar se të gjitha ankesat e paraqitura nga mbrojtja dhe janë refuzuar nga Gjykata e Apelit. Prokuroria e Apelit zakonisht i ka përsëritur arsyet e paraburgimit të paraqitura në kërkesën fillestare dhe ka rekomanduar që ankesa të hidhet poshtë si e pabazuar.

OSBE-ja ka vërejtur se vetëm në dy raste Gjykata e Apelit ka dhënë arsye më substanciale në krahasim me gjykatat e shkallës së parë.

Në një rast, Gjykata e Apelit e konsideroi si të pamjaftueshëm arsyetimin mbi dy baza - rrezikun e ikjes dhe rrezikun e kryerjes së veprave tjera. Gjykata megjithatë e vërtetoi aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake për caktimin e paraburgimit bazuar në rrezikun e pengimit të rrjedhës së procedurës penale.

Megjithatë, në pesë rastet e tjera, Gjykata e Apelit është pajtuar me Gjykatën Themelore për arsyet e paraburgimit, edhe kur aktvendimi i shkallës së parë ka dhënë arsye mjaft të

përgjithshme për këto aktvendime dhe/ose nuk e ka individualizuar aktvendimin në pjesë të ndara për secilin të pandehur.

Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar së fundmi dy kërkesa lidhur me kushtetutshmërinë e vendimeve të paraburgimit. Gjykata i miratoi pjesërisht të dyja kërkesat – në veçanti duke gjetur se Gjykata Themelore nuk e kishte respektuar afatin kohor prej katër muajsh për paraburgim gjatë fazës së hetimit (para-aktakuzës) që vlen për veprat penale të hetuara në këto raste. Në rastin nr. KI55/22 të parashtruesit Sasha Spasiq, aktvendimi theksonte se,

*“Gjykata, përmes këtij aktgjykimi, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë përcjell kërkesën dhe udhëzimin që duhet t'u shërbejë gjykatave të rregullta, që për të plotësuar kriteret kushtetuese të nenit 29 [E drejta për Liri dhe Siguri] të Kushtetutës, si dhe me kriteret e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, siç interpretohet gjerësisht nga GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore, arsyetimi i tyre për zgjatjen e paraburgimit në pritje të gjykit duhet të trajtojë dhe të përmbajë arsyetim dhe vlerësim të individualizuar të pretendimeve thelbësore të të pandehurve dhe që lidhen me ligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit të tyre.”<sup>96</sup>*

<sup>96</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim në Rastin Nr. KI55/22, Parashtruesi Sasha Spasiq, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [2022:19820] të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të datës 17 maj 2022 dhe Aktvendimit [PN1 nr. 704/2022] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 31 majit 2022, paragrafi 126. E qasshme në: [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/ki\\_55\\_22\\_agj\\_ang.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/ki_55_22_agj_ang.pdf) (qasur më 3 gusht 2023).

## 5. KONKLUZION

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nënvizojnë se paraburgimi duhet të jetë përjashtim dhe jo rregull. Megjithatë, analiza e OSBE-së tregon se alternativat ndaj paraburgimit rrallë merren parasysh. Prokurorët shpesh kërkojnë paraburgim dhe shumica dërrmuese e kërkesave miratohen nga gjykata. Kur kombinohet me shqetësimet në lidhje me cilësinë e arsyetimit dhe argumentimit si në kërkesat e prokurorisë ashtu edhe në vendimet gjyqësore, është gjetur se paraburgimi shpesh nuk përdoret vetëm si mjete i fundit dhe mund të zbatohet në mënyrë arbitrare.

Këto shqetësime ishin veçanërisht të dukshme në rastet me të pandehur të shumtë. Ndërkohë që këto raste janë padyshim më sfiduese dhe kërkojnë kohë për gjyqtarët dhe prokurorët, ekziston obligimi që të shqyrtohen dhe merren në konsideratë kërkesat bazuar në rrethanat individuale të secilit të pandehur. Gjithashtu, gjykatat duhet të jenë të vetëdijshme se zbatimi i paraburgimit për shkak të karakteristikave të të pandehurit (si person që jeton jashtë Kosovës) është potencialisht diskriminues.<sup>97</sup> Për më tepër, paraburgimi nuk duhet të shqiptohet në mënyrë rutinore për kategori të caktuara veprash.

Për të adresuar këto shqetësime dhe për të shmangur kritikën e mundshme, si dhe për të ofruar siguri më të madhe juridike, kërkesat e prokurorisë dhe vendimet gjyqësore duhet të theksojnë qartë dhe në mënyrë të plotë arsyet dhe rrethanat e aplikueshme që i përkasin secilit të pandehur individual.

Në nivel politikash dhe në përputhje me rekomandimin e fundit të Këshillit të BE-së,<sup>98</sup> duhet t'i kushtohet vëmendje zgjerimit të listës së "masave më të buta" në dispozicion që një gjykatë mund të përdorë si alternativë ndaj paraburgimit. Për shembull, "monitorimi elektronik" ose programet e diversitetit mund të ofrojnë alternativa efektive dhe të zbatueshme ndaj paraburgimit në disa raste. Megjithatë, kjo së pari do të kërkonte vlerësim nëse sistemet e tilla do të ishin të realizueshme dhe të përballueshme në Kosovë.

Përderisa ka pasur përmirësime në ofrimin e përfaqësimit të mbrojtës për të akuzuarit, ka ende shqetësime lidhur me cilësinë e përfaqësimit. Avokatët mbrojtës duhet ta shtyjnë në mënyrë proaktive rastin e klientit të tyre për lirim në pritje të gjykimit dhe janë në pozitë unike për t'i shpjeguar rrethanat personale të të pandehurit, të cilat mund të jenë vendimtare për ta bindur gjykatën që të mos e urdhërojë paraburgimin.

<sup>97</sup> Rekomandimi i Komisionit të BE-së i datës 8.12.2022 për të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të akuzuarve që i nënshtrohen paraburgimit dhe për kushtet materiale të paraburgimit paragrafi 23.

<sup>98</sup> *Ibid.*

Për sa i përket ankesave, rezulton se në shumicën e rasteve, Gjykata e Apelit lë në fuqi vendimet e shkallës së parë për paraburgimin. Gjithashtu, shqetësimet e raportuara më parë në lidhje me shkeljet e rregullta të afateve kohore për procedurat e ankimimit vazhdojnë të mbesin të njëjta.

Vlen të përmendet se përderisa KPP krijon detyrim të përgjithshëm për të përshpejtuar rastet në të cilat i pandehuri është në paraburgim, nuk ka kufizime kohore për paraburgimin pas ngritjes së aktakuzës. Kjo do të thotë se ekziston një obligim për gjyqtarët e procedurës paraprake që shqyrtojnë paraburgimin, për të vlerësuar vazhdimisht domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e vazhdimin të paraburgimit.

Të dhënat tregojnë se 38 për qind e të paraburgosurve në Kosovë nuk janë dënuar dhe kjo përqindje duket se është në rritje. Andaj, avokatët mbrojtës, prokurorët dhe gjyqësori duhet të jenë të vetëdijshëm se paraburgimi është masë e fundit dhe nuk duhet të caktohet në mënyrë rutinore. Si arbitri përfundimtar për përshtatshmërinë e masës së paraburgimit, gjyqtari duhet të shqyrtoj dhe vendos për kërkesat e prokurorisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## 6. REKOMANDIME

### Për Ministrinë e Drejtësisë:

- Të hulumtohet mundësia e sistemeve të monitorimit elektronik që mund të përdoren për të monitoruar vendndodhjen e të liruave nën masa më të vogla. Kjo do të mundësonte më shumë alternativa ndaj paraburgimit, siç janë kriteret për kufizim të lëvizjes, si dhe do të mundësonte zbatim më të mirë të masave ekzistuese; p.sh. arrestit shtëpiak.<sup>99</sup>
- Të merret parasysh futja e programeve të diversitetit, veçanërisht për shkelësit për herë të parë, dhe për veprat penale që lidhen me drogë, ato që nuk janë të dhunshme dhe që lidhen me shëndetin mendor, si alternativë ndaj paraburgimit.

### Për Kryeprokurorinë, Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial të Kosovës:

- Të sigurohet se ekzistojnë mekanizma për përshpejtimin dhe prioritizimin e rasteve kur i pandehuri ndodhet në paraburgim, në përputhje me kriteret e KPP-së.<sup>100</sup>

### Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- Të sigurohet që të dhënat të mblidhen dhe, nëse është e mundur, të publikohen, për përdorimin e paraburgimit dhe masave më të buta, duke përfshirë numrin/përqindjen e të pandehurve të paraburgosur nga gjykata të ndryshme duke përfshirë periudhat për të cilat ata janë paraburgosur.
- Të merret parasysh bërja e një shqyrtimi të rasteve ku i pandehuri është mbajtur në paraburgim, por, kur është dënuar, ka marrë dënim që nuk përfshinë burgimin efektiv.

### Për Odën e Avokatëve të Kosovës:

- Të ofrohen trajnime për avokatët mbrojtës për të siguruar që ata të mund të kundërshtojnë në mënyrë efektive kërkesat e prokurorisë për paraburgim dhe të mbrojnë të drejtën e klientëve të tyre për liri. Trajnime të tilla duhet të përfshijnë shqyrtimin e standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>101</sup>

99 Meqenëse kufizimi i lëvizjes aktualisht nuk parashihet si masë më pak kufizuese, zbatimi i saj do të kërkonte edhe ndryshim e plotësim të KPP-së.

100 Neni 182, Kodi i Procedurës Penale, 17 gusht 2022, thotë se rastet kur i pandehuri ndodhet në paraburgim duhet të trajtohen me 'urgjencë të veçantë'.

101 Këshilli i Evropës ka kurse të quajtura HELP si burim i dobishëm në këtë drejtim. Shih "Edukim për profesionistët ligjor mbi të drejtat e njeriut (HELP)", <https://help.elearning.ext.coe.int/> (e qasur më 18 korrik 2023).

### Për Akademinë e Drejtësisë:

- Të vazhdohet puna me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Zyrën e Kryeprokurorit për të siguruar që të plotësohen nevojat për trajnim të juristëve në lidhje me paraburgimin në rastet kur bëhen kërkesat e paraburgimit.
- Të sigurohen trajnime praktike për paraburgimin mbi kërkesat e paraburgimit që i edukojnë pjesëmarrësit për standardet përkatëse ndërkombëtare, duke përfshirë për kërkesat dhe vendimet mjaftueshëm të arsyetuara dhe të individualizuara.
- Të ofrohet trajnim për masat alternative ndaj paraburgimit, duke përfshirë arsyetimin nëse këto alternativa ndaj paraburgimit duhet përdoren apo jo.

## SHTOJCA A

### Ndryshimet kryesore në Kodin e Procedurës Penale të vitit 2022 (në fuqi nga shkurti 2023) në lidhje me paraburgimin

#### Neni 162 - Arrestimi dhe ndalimi në fazën e hetimit

Paragrafi (5): Prokurori mund të lëshoj vendimin me shkrim për ndalim edhe pa emrin e personit të arrestuar, përderisa ai i paraqet të dhënat për identifikimin e duhur të personit.<sup>102</sup> Po ashtu, kundër vendimit me shkrim të prokurorit për caktimin e ndalimit, personi i arrestuar ose mbrojtësi i tyre mund të paraqesin ankesë brenda gjashtë orëve nga pranimi i vendimit. Gjyqtari i procedurës paraprake është personi kompetent për të vendosur lidhur me ankesën, brenda 12 orëve nga pranimi i ankesës. Në versionin e mëparshëm të këtij neni, të arrestuarit nuk kishin mundësi ankimi kundër vendimit të prokurorit.

Paragrafi (6): Afati për paraqitjen e kërkesës së prokurorit për paraburgim është 36 orë, ndërsa në versionin e mëparshëm ishte 24 orë. (Neni i mëparshëm 164(7))

#### Neni 165 - Njoftimi i të arrestuarit për të drejtat e tij

Nënparagrafët (1.3), (1.6) dhe (1.7): këto nënparagrafë të rinj i shtojnë të drejtat e personit të arrestuar, respektivisht të drejtat për: qasje në shkresat e lëndës; t'u informuar për numrin maksimal të orëve që mund të privohen nga liria para se të sillen para gjykatësit; dhe e të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose për të bërë kërkesë për lirim.

#### Neni 171 - Masat e autorizuara për sigurimin e pranisë së të pandehurit

Paragrafi (6): ky paragraf i ri shton mundësinë që gjykata të shqiptojë njëkohësisht një ose më shumë masa (thirrja; urdhër arresti; premtimi i të pandehurit që të mos largohet nga vendbanimi aktual; ndalimi për t'iu afruar një vendi apo personi të caktuar; paraqitja në stacion policor, dorëzania, arresti shtëpiak dhe paraburgimi).

#### Neni 172 Thirrja

Paragrafët (5) dhe (6): e parashohin thirrjen elektronike. Dispozitat e reja lejojnë që gjykata të kërkojë nga palët dhe avokati mbrojtës që të japin adresat e tyre elektronike për thirrjet që do të dërgohen përmes postës elektronike dhe e bëjnë të detyrueshme që palët të njoftojnë gjykatën nëse ka ndryshime në informacionin e kontaktit të tyre elektronik, si dhe adresat ose vendbanimin e tyre.

<sup>102</sup> Kjo i vlente edhe për nenin 163(2.1) lidhur me kërkesën e prokurorit për marrjen e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

## **Neni 177 Dorëzania**

Dorëzania është bërë më e lehtë për t'u zbatuar nga gjykatat, duke hequr kushtet shtesë që ishin të pranishme në nenin 179 (2) të kodit të mëparshëm dhe duke lënë si kusht vetëm dyshimin e bazuar, rrezikun e arratisjes dhe premtimin se i pandehuri nuk do të fshihet apo largohet nga vendbanimi pa marr leje. Prandaj, është në diskrecionin e gjykatës, që të vendosë, bazuar në faktet e rastit, nëse dorëzania është masë e mjaftueshme apo jo.

## **Neni 178 dhe 180 – Aktvendimi për dorëzani dhe heqja e dorëzanisë**

Neni 178 (3) shton mundësinë që aktvendimi për heqjen e dorëzanisë të jepet pas seancës, duke lejuar kështu që palët të dëgjohen. Neni 180 pika 1 shton kushtin që, nëse i pandehuri, pas thirrjes me rregull nuk paraqitet dhe mungesën nuk e arsyeton apo nëse përgatitet të ikë, shuma e dhënë si dorëzani i caktohet Programit për kompensim të viktimave të krimit sipas nenit 179 (3).

**Diversiteti është hequr si masë për të siguruar praninë e të pandehurit.**

## **Neni 186 - Përmbajtja e aktvendimit për caktimin e paraburgimit dhe ankesa kundër tij**

Paragrafi (3): Afati për ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës për caktimin e paraburgimit është zgjatur në 48 orë (në versionin e mëparshëm të nenit - ish-neni 189(3) ishte 24 orë). Gjithashtu, afati i vendimit të Gjykatës së Apelit për ankesat është shtyrë në 72 orë nga data e paraqitjes së përgjigjes (më parë ishte 48 orë nga paraqitja e ankesës).

## **Neni 188 - Vazhdimi i paraburgimit**

Paragrafi (1): Paragrafi sqaron afatin brenda së cilit prokurori duhet të paraqesë kërkesën për vazhdimin e paraburgimit në fazën e hetimit: prokurori duhet të kërkojë vazhdimin e afatit jo më vonë se pesë ditë para skadimit të aktvendimit për paraburgim.



## SHTOJCA B

### Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi bazat e paraburgimit

*Praktika gjyqësore lidhur me nenin 5(1)(c) të KEDNJ-së në lidhje me legjitimitetin dhe domosdoshmërinë e paraburgimit:*

Në një rast të trajtuar nga GJEDNJ, Gjykata vuri në dukje se arsyetimi i vendimit të paraburgimit është faktor relevant për të përcaktuar nëse paraburgimi duhet të konsiderohet arbitrar.<sup>103</sup> dhe për këtë arsye, GJEDNJ-ja merr parasysh mungesën e arsytimit si komponent i ligjshmërisë së paraburgimit sipas nenit 5(1).<sup>104</sup> Në fakt, në rastet e paraburgimit, autoritetet gjyqësore kanë për detyrë të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, duke shqyrtuar të gjitha faktet që arsyetojnë shmangien nga rregulli i respektimit të lirisë individuale dhe duhet t'i paraqesin ato në vendimet rreth kërkesave.<sup>105</sup>

Së dyti, gjykata e interpretoi nenin 5(1)(c), i cili e përmend në veçanti paraburgimin, duke thënë se lejon paraburgimin *"me qëllim të sjelljes së një personi përpara autoritetit ligjor kompetent për dyshimin e arsyeshëm se ka kryer veprë penale"*.<sup>106</sup>

*Praktika gjyqësore për nenin 5(3)(c) të KEDNJ-së në lidhje me vendimet e paraburgimit mjaftueshmërisht të arsyetuara:*

Për sa i përket nenit 5(3), GJEDNJ-ja tha qartë se ai *"nuk mund të shihet si nen që autorizon paraburgimin pa kushte"* qoftë edhe kur paraburgimi i tillë mund të jetë për periudhë të shkurtër kohore.<sup>107</sup> Në fakt, çdo periudhë paraburgimi, qoftë edhe e shkurtër, duhet të arsyetohet dhe demonstron nga autoritetet gjyqësore.<sup>108</sup> Në lidhje me kërkesën për të arsyetuar paraburgimin, GJEDNJ ka theksuar se *"duhet të ketë arsye relevante dhe të mjaftueshme"*<sup>109</sup> dhe arsyetimi pro dhe kundër lirimit të një personi, sipas nenit 5(3), nuk mund të jetë abstrakt dhe i përgjithshëm, por në vend të kësaj duhet të përbëhet nga fakte specifike dhe rrethana personale.<sup>110</sup>

Në këtë aspekt, GJEDNJ i përcaktoi arsyet e pranueshme për refuzimin e dorëzarisë, të cilat janë si vijon:

- a) rreziku që i akuzuari të mos paraqitet në gjykim/rreziku i arratisjes;
- b) rreziku që i akuzuari, nëse lirohet, do të ndërmernte veprime për të cenuar administrimin e drejtësisë; ose
- c) rreziku që i akuzuari, nëse lirohet, do të kryente vepra të tjera; ose
- d) rreziku që i akuzuari, nëse lirohet, do të shkaktonte trazira publike.<sup>111</sup>

<sup>103</sup> S., V. dhe A. kundër Danimarkës, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 tetorit 2018, para. 92

<sup>104</sup> GJEDNJ, Udhëzues për nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, par. 45

<sup>105</sup> Buzadji kundër Republikës së Moldavisë, Aktgjykimi i GJEDNJ i 5 korrikut 2016, para. 91

<sup>106</sup> Kurt kundër Austrisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 15 qershorit 2021, par. 187

<sup>107</sup> GJEDNJ, Udhëzues për nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, par. 210

<sup>108</sup> Tase kundër Rumanisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 10 qershorit 2008, par. 40

<sup>109</sup> S., V. dhe A. kundër Danimarkës, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 tetorit 2018, para. 77.

<sup>110</sup> Aleksanyan kundër Russisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 dhjetorit 2008, par. 179

<sup>111</sup> Becciev kundër Moldavisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 4 qershorit 2005 par. 57

### a. Rreziku i mosparaqitjes në gjykatë

Lidhur me këtë bazë, Gjykata vendosi se ashpërsia e dënimit që i kanosej të akuzuarit nuk mund të jetë baza e vetme për të pohuar se ekziston një rrezik i tillë. Ekzistimi i këtij rreziku duhet të vlerësohet së bashku me rrethanat të tjera relevante, si " *karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha llojet e lidhjeve me vendin në të cilin ai ndiqet penalisht* ".<sup>112</sup> Mungesa e vendbanimit të përhershëm të të akuzuarit gjithashtu nuk mund të konsiderohet si rrethanë më vete,<sup>113</sup> as rreziku i arratisjes nuk mund të lindë thjesht nga lehtësia e kalimit të kufirit, pasi në këto raste mund të kërkohet dorëzimi i pasaportës.<sup>114</sup> Është i gjithë grupi i rrethanave që duhet të merren parasysh, duke përfshirë edhe rastet e mëparshme në të cilat i pandehuri ishte përpjekur të shmangte procesin penal duke u larguar nga vendi dhe indikacione specifike të planeve për t'u arratisur.<sup>115</sup>

### b. Rreziku i pengimit të procedurës

GJEDNJ ka vendosur se një bazë e tillë nuk mund të përcaktohet "*in abstracto*", duhet të mbështetet me prova faktike dhe jo të bazohet në gjasat e një dënimi të rëndë.<sup>116</sup> Për shembull, mund të arsyetohet në disa raste komplekse, si ato të veprimtarive dhe bandave kriminale të organizuara ose në rastet kur i pandehuri mund të ketë lidhje personale me shumë nga dëshmitarët.<sup>117</sup>

### c. Rreziku i përsëritjes së veprave penale

GJEDNJ-ja theksoi se paraburgimit mund të caktohet për akuza të rënda për të parandaluar përpjekjet për të kryer vepra të mëtejshme, por është e nevojshme që rreziku i tillë të jetë "*i besueshëm dhe masa të jetë e përshtatshme, në frymën e rrethanave të rastit dhe në veçanti të kaluarën dhe personalitetin e personit në fjalë*".<sup>118</sup> Prandaj, kjo mund të trajtohet vetëm në mënyrë specifike në secilin rast. E kaluara mund të përfshijë bindje të mëparshme që mund të japin bazë për një frikë të arsyeshme të përsëritjes, përveç nëse ato nuk janë të një natyre ose serioziteti të krahasueshëm.<sup>119</sup> Për më tepër, në rrethanat e personit në fjalë, mungesa e punës ose e familjes nuk mund të presupozojë që personi mund të jetë i prirur për të kryer vepra të reja.<sup>120</sup>

### d. Ruajtja e rendit publik

Disa vepra, për shkak të peshës së tyre, mund të çojnë në trazira shoqërore ose prishje të rendit publik. Gjykata ka vendosur se kjo duhet të "*bazohet në fakte që mund të tregojnë se lirimi i të akuzuarit në të vërtetë do të shkaktojë prishje të rendit publik*".<sup>121</sup>

112 *Becciev kundër Moldavisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 4 qershorit 2005 par. 58

113 *Sulaoja kundër Estonisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 15 shkurtit, par. 64

114 *Shih Stögmüller kundër Austrisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 10 nëntorit 1969, par. 15

115 *Cesky kundër Republikës Çeke*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 6 qershorit 2000, par. 79

116 *Becciev kundër Moldavisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 4 qershorit 2005 par. 59; *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 28 nëntorit 2017, par. 224

117 *Gładczak kundër Polonisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 31 majit 2007, par. 55; *Contrada kundër Italisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 24 gushtit 1998, par. 60

118 *Clooth kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 12 dhjetorit 1991, par. 40; *shih gjithashtu Kurt kundër Austrisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 15 qershorit 2021, par. 187

119 *Clooth kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 12 dhjetorit 1991, par. 40

120 *Sulaoja kundër Estonisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 15 shkurtit, par. 64

121 GJEDNJ, *Udhëzues për nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, par. 226-227.



